




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION



Referencë: **IPK/22082023/DI**
Datë: **22.08.2023**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Ferizajt
Referenca	- 05/2023
Data e inicimit	- 26.05.2023
Data e raportimit	- 22.08.2023
Arsyet e inicimit	- Më 26.05.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së e ka konsideruar të nevojshme zhvillimin e një inspektimi në Stacionin Policor të Ferizajt. Në kërkesën e drejtuar në adresë të Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i një inspektimi të shpejtë e të thelluar në të gjitha funksionet e këtij Stacioni. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse Stacioni është duke realizuar objektivat në përmbushje të mandatit ligjor për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus të veçantë në fushat: burimet njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative - mbështetëse.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit dhe angazhimit të burimeve njerëzore, - Vlerësimi i aktiviteteve operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, - Vlerësimi i aktiviteteve hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, - Vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe kushteve të punës.
Metodologjia e inspektimit	- <u>Takime - intervista</u> me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve: (a) Komandanti i Stacionit Policor, (b) Shefi i Sektorit të Operativës, (c) Shefi i Sektorit të Hetimeve, (d) Shefi i Sektorit të Resurseve, (e) Mbikëqyrësit e ndërrimeve; - <u>Këqyrje - verifikime</u> mbi: sistemin e personelit, prezencën fizike në punë, respektimin e uniformës - dukjen personale, gjendjen e pajisjeve, adresimin e shkeljeve disiplinore, vlerësimin e rezultateve të punës, reagimin në thirrje, llogaridhënien, procedimin e lëndëve, patrullimin, zbatimin e urdhëresave, raportimin e përdorimit të forcës, trajtimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve, planifikimin, policimin në bashkësi, dosjet penale, kujdesin ndaj dëshmitë, funksionalitetin e automjeteve, masat e sigurisë, kushtet teknike, etj.; - <u>Marrje dokumentesh</u> fizike/elektronike, si: vendime, kontrata, përshkrime të punës, regjistri i vijueshmërisë, raporte të kontrollit, raporte periodike, dosje disiplinore, raporte të vlerësimit të rezultateve, logu ditor, raporte ditore dhe

	24 orë, raporte fillestare të incidentit, orari, dosje kundërvajtjesh, urdhëresa, dosje për përdorim force, dosje të ndalimit, kërkesa për verifikim të kaluarës kriminale, plane operative, pro - forma, raporte mbi policimin në bashkësi, dosje të dhunës në familje, zinxhirë të ruajtjes, regjistra dëshmesh, regjistri i qasjes në Dhomë të dëshmime, raporte të kontrollit të dëshmime, raporte mbi automjetet, fletë udhëtime, Regjistri i pasurive, Plani i evakuimit, etj.
Subjekti	- Stacioni Policor i Ferizajt në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Ferizajt
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 31.05.2023; - Përfundimi - 01.06.2023; - Periudha e mbulimit - dy (2) vitet e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, - Kodi i Procedurës Penale, - Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, - Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, - Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, - Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, - UA nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, - UA nr. 02/2012 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor, - UA nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në PK, - UA nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës, - UA (MI) nr. 01/2018 për Kontrollimin Teknik të Automjeteve, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - Rregullore (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, - PSO - Koha e reagimit (7 shtator 2018), - PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (25.08.2020), - PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës, - PSO - Verifikimi i të kaluarës kriminale (22 shkurt 2021), - PSO - Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës (1 tetor 2020), - PSO - Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje (8 prill 2022), - PSO - Dhomat e dëshmime (15 maj 2014).
Ekipi realizues	- Fitore Gajraku, inspektore, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektore, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektore, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Asistencë, Trajnime dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i PK-së
Datë	- 22.08.2023

Shkurtesat

DTIK	Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
EDHRT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që shpie në Terrorizëm
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KSHPF	Komisioni i Shqyrtimit të Përdorimit të Forcës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PSO	Procedura Standarde e Operimit
PUI	Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca
QOKR	Qendra Operative Komunikuese Rajonale
QPS	Qendra për Punë Sociale
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✦ Nga 15 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi organizimin dhe burimet njerëzore policore, janë evidentuar dobësi në çështjet lidhur me tejkalimin e numrit të lejuar të personelit, mos furnizimin (zëvendësimin) me sprej kimik dhe radiolidhje, si dhe mos përfshirjen e një pjese të personelit hetimor në programe trajnuese specifike.
- ✦ Nga 16 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi aktivitetin operativ policor, janë evidentuar dobësi në çështjet lidhur me efikasitetin jo të kënaqshëm të njësive operative në realizimin e urdhëresave të gjykatave, mos dokumentimin e veprimeve policore në realizimin e urdhëresave dhe mos regjistrimin në SIPK të "shënimeve zyrtare" (pro formave).
- ✦ Nga tetë (8) fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi parandalimin dhe hetimin e krimit, janë evidentuar dobësi në çështjet që lidhen me mos raportimin me shkrim në disa raste mbi dyshimin e arsyeshëm për veprat penale dhe mos respektimin e zinxhirit të plotë komandues sa i përket procedimit të kallëzimeve penale në Prokurorinë e Shtetit.
- ✦ Nga 11 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së mbi kushtet teknike të punës dhe të sigurisë, janë evidentuar dobësi në çështjet që lidhen me mos mbushjen e aparateve kundër zjarrit, lagështinë në Qendrën e Ndalimit dhe cilësinë e ushqimit për të ndaluarit. Po ashtu, janë hasur vështirësi në funksionalitetin e pajisjeve të kontraktuara (fotokopjeve).



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorin Rajonal dhe Drejtorin e Personelit të ndërmarrin veprime në adresimin e çështjeve që lidhen me sistemin dhe shpërndarjen e drejtë të personelit konform Rregullores së organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Policinë e Kosovës (24.03.2023).
2. Për arsye të sigurisë, IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Logjistikës që të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me sprej dhe radiolidhje.
3. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Divizionin e Trajnimeve të ndërmarr hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të hetuesve të Stacionit në programet trajnuese apo kurse nga fusha e hetimit të krimit dhe trajtimit të dhunës në familje.
4. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të rrisin angazhimet në drejtim të ngritjes së shkallës së realizimit të urdhëresave të gjykatave.
5. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të ushtrojnë kontrolle mbi njësinë përkatëse për ndërlidhje me Gjykata, që për të gjitha veprimet policore në drejtim të ekzekutimit të urdhëresave, të evidentohen dhe dokumentohen me shkrim brenda përmbajtjes së dosjes.
6. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të analizojnë dhe vlerësojnë faktorët që ndikojnë në numrin e lartë të të arrestuarve në raport me numrin e policëve, por edhe të shtimit të raporteve për përdorimin e forcës.
7. IPK-ja i rekomandon Shefit të Operativës që të ushtrojë kontroll mbi Zyrën e SIPK-ut në mënyrë që të gjitha rastet e mbetura me Shënim zyrtar (pro forma) të regjistrohen në SIPK.

8. *IPK-ja i rekomandon Sektorit të Hetimeve që posa Policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, Policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë Prokurorin e Shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve (neni 71, paragrafi 6 i KPP-së).*
9. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Hetimeve që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët para se ato të procedohen në Prokurorinë e Shtetit, të aprovohen së pari nga hetuesi i lëndës, mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas nga Shefi i Sektorit të Hetimeve bazuar në PSO-Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.*
10. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës të sigurojnë shërbimet e kontraktuara për mbushjen e pajisjeve kundër zjarrit, për të siguruar se pajisjet e tilla janë në gjendje funksionale në rast fatkeqësish.*
11. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me shërbimet mbështetëse të Policisë të adresojnë çështjen e lagështisë brenda Qendrës së Ndalimit, si dhe cilësinë e ushqimit për të ndaluarit.*
12. *IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të adresojë problemet e Stacionit Policor të Ferizajt lidhur me vështirësitë teknike në funksionimin e duhur të pajisjeve të kontraktuara (fotokopjeve).*

Faktet kyçe



Zona e përgjithshme e përgjegjësisë

345 km²

Zona e kontrollit për polic (2022)

2.4 km²Raporti polic - banorë¹

1:744



Trendi i krimit (2022)

Ferizaj Stacionet²

+0.17%

+1.1%

Numri i veprave penale për polic (2022)

12.2

8.7

Numri i veprave penale në 1.000 banorë (2022)

16.3

14.5

Zbulueshmëria e veprave penale (2022)

61.5%

63.4%



Koha e përgjithshme e reagimit në thirrje

Ferizaj (2022/2023)

8.49 m

10 m

Koha e reagimit në zonë urbane

8.1 m

9.7 m

Koha e reagimit në zonë rurale

11.4 m

12.9 m

% e reagimit me kohë dhe të shtyrë (raporti)

94:6

89:11



Shkalla e ekzekutimit të urdhëresave (2022)

Ferizaj Stacionet

59%

75%

Numri i të arrestuarve për polic (për vit)

6.5

3.9

Numri i të ndaluarve për polic (për vit)

1.3

1.5



Trendi i patrullimeve në këmbë (2022)

Ferizaj Stacionet

-4%

-1.7%

Trendi i patrullimeve me automjet (2022)

-4.5%

+11.9%

Trendi i pikave të kontrollit (2022)

-4.1%

-1.9%



Trendi i gjobave (2022)

Ferizaj Stacionet

+80%

+35.5%

Numri i gjobave në raport me banorët (për vit)

1:4.6

1:6.1

Numri i gjobave për polic (për vit)

1:162

1:97.9

¹ Sipas Vjetarit Statistikor, popullsia e vlerësuar e Komunës së Ferizajt më 31.12.2021 është 105.663 banorë.

² Analiza mbi krimin përfshinë të dhënat mbi mesataren e përgjithshme të derivuar nga 37 stacionet policore të Divizionit të Sigurisë Publike (përfshirë katër stacione në pjesën veriore të vendit). Analiza mbi raportin e krimit me numrin e banorëve merr parasysh popullsinë që gjendet në zonën e përgjegjësisë së këtyre stacioneve (1.773.971-38.560=1.735.411 banorë).

Gjetjet kryesore:



1. Organizimi dhe burimet njerëzore

1.1. Elementi më i rëndësishëm i organizatës policore janë burimet e saj njerëzore. Duke konsideruar se paraqesin një vlerë qenësore, shtrohet nevoja për organizimin dhe shpërndarjen e mirëfilltë të tyre. Policia është e organizuar bazuar në Ligjin për Policinë dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Kur jemi te Stacioni Policor i Ferizajt, IPK-ja ka në fokus organizimin e brendshëm të bazuar në Strukturën organizative, aprovuar më 28.02.2019. Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (neni 31), sistemimi dhe transferi i personelit policor, në vendet dhe detyrat e punës, duhet t'iu përshtatet nevojave operacionale dhe Strukturës organizative të policisë. Neni 29 i Rregullores për Personel dhe Administratë përcakton që zyrtarët policor, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i ushtrojnë bazuar në përshkrimet e vendeve të punës për pozitën, në të cilat janë emëruar. Në Stacion janë hasur gjithsej tre raste me mospërputhje pozitë-gradë. Në Sektorin e Hetimit, një pozitë drejtuese mbahet nga një punonjës me gradë toger (ID-1775), për të cilën parashihet të jetë kapiten. Zyra e Komunitetit udhëhiqet nga një zyrtar policor (ID-8481), e cila pozitë duhet të udhëhiqet nga një punonjës me gradën rreshter. Në Sektorin Policor C, pozita që parashihet të mbahet nga një rreshter, ushtrohet nga një zyrtar policor (ID-8749).

1.2. Sipas nenit 37 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përkohësisht caktohet ushtruesi i detyrës. Gjatë inspektimit nuk janë hasur raste që pozitën në kuadër të Strukturës të ushtrohen me ushtrues detyre.

1.3. Siç u potencua në paragrafin 1.1, sistemimi i personelit në vende të punës duhet t'iu përshtatet nevojave dhe Strukturës organizative. Inspektimi vë në pah se dy (2) zyrtarë policor (ID-8230 dhe ID-2034) që me vendime janë të caktuar në ekipe reaguese, janë të sistemuar me punë të lehtë në Zyrën për Personel dhe Logjistikë, në mungesë të shërbyesve civil. Nga radhët e shërbyesve civil nuk ka zyrtarë të pa sistemuar në kuadër të Strukturës. Sa i përket funksionalizimit të Strukturës në kuadër të Stacionit të gjitha njësitë që parashihen janë funksionale, por është e organizuar edhe një Zyrë, e cila nuk është e paraparë me Strukturë deri më tani (Zyra e Armëve). Me Strukturën e re parashihet që në Sektorin e hetimeve të funksionoj si ndarje e veçantë Dhoma e Dëshmime dhe Aplikimit për Armë.

1.4. Është analizuar gjendja sasiore me burime njerëzore, duke i krahasuar me ato që i parasheh Struktura organizative. Më 31.12.2022, Stacioni ka pasur gjithsej 149 punonjës, megjithëse me Strukturë organizative (28.02.2019) është paraparë të ketë 122 punonjës. Në fund-vit ka pasur tejkalim të numrit të punonjësve në masën prej 22.1%. Këtë vit është rekrutuar dhe një numër i konsideruar i policëve, ku Stacioni ka përfituar nga procesi duke shtuar kapacitetet dhe tashmë ka 174 punonjës, nga të cilët, 168 të uniformuar dhe gjashtë (6) shërbyes civil. Është kjo një gjendje sasiore me burime njerëzore përtej planifikimeve, në disharmoni dhe me Listën e Personelit të Autorizuar (Strukturës së re) që parasheh një total prej 116 punonjësish, nga të cilët, 107 të uniformuar dhe nëntë (9) shërbyes civil. Stacioni tashmë ka një tepriçë të punonjësve në masën prej 50%. Ky tejkalim përcillet me mospërputhje të numrit të punonjësve nëpër njësi, në raport me numrin e lejuar. Meqë veprat që lidhen me dhunën në familje kanë marrë fokusin e veçantë në analizën e IPK-së, duhet cekur se në Ekipin për hetimin e dhunës në familje janë të sistemuar katër (4) zyrtarë policor, që merren me rastet e dhunës në familje (një mbikëqyrës dhe tre hetues). Nga ta në cilësi të hetuesit primar të dhunës në familje nuk ngarkohet me raste tjera, siç parashihet me PSO - Parandalimi dhe trajtimi i dhunës në familje.

1.5. Sipas Rregullores, punonjësi i policisë duhet të paraqitet në detyrë në kohën dhe vendin e caktuar, në detyrat që i janë caktuar me orar paraprak, apo kur kërkohet

	intervenim i menjëhershëm³. Udhëzimi Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në nenin 57 përcakton se punonjësit e punësuar në Polici duhet të vijnë në punë dhe të dalin nga puna me kohë dhe të shkojnë për drekë në kohën e përcaktuar. IPK-ja ka qenë në Stacion para fillimit të ndërrimit të orës 07.00-15.00 dhe orarit të rregullt 08.00-16.00. Inspektorët kanë siguruar Regjistrin e vijueshmërisë për personelin që ndjekë Orarin e punës 08.00-16.00 (në administratë, hetime dhe sektorë), por jo dhe të ndërrimeve (ekipe reaguese). Sipas mbikëqyrësit të ndërrimit fillimisht sigurohet ardhja në punë e personelit, konfirmohen mungesat dhe më pas hartohet Orari, duke nënkuptuar se Regjistri i vijueshmërisë nuk mbahet, por evidencë mbetet Orari. IPK ka verifikuar vijueshmërinë në punë dhe ka krahasuar prezencën fizike me regjistrat. Evidenca mbi vijueshmërinë është përputhur me prezencën fizike të punonjësve në punë. Prezenca në punë monitorohet nga menaxhmenti, kurse administrimi i tyre realizohet nga Sektori i Resurseve/Operativës. 1.6. Bartja e pajisjeve për zyrtarë policor është rregulluar me Rregullore për Personel dhe Administratë. Neni 145 lidhur me pajisjet e autorizuar (rripi i uniformës dhe pajisjet që vendosen në rrip) rregullon se punonjësit policor, të cilët kanë autorizime policore, derisa janë në uniformë dhe në kryerje të detyrës, duhet t'i bartin pajisjet, për të cilat janë të autorizuar. Lidhur me pajisjet policore janë inspektuar pesë (5) zyrtarë policor⁴, ku ka rezultuar se ata janë të pajisur me pistoletë "Glock" me karikatorë dhe municion të nevojshëm të përcaktuar me rregulla, shufra dhe pranga. Vetëm një nga policët ka pasur sprejin. Njëri nga ta ka prezantuar baterinë (llambën ndriçuese) për dallim prej katër (4) të tjerëve që edhe pse janë të ngarkuar me to, nuk i kanë pasur. Me radiolidhje ka qenë i pajisur vetëm një nga policët e inspektuar. Rregullorja përcakton bartjen e pajisjeve dhe Stacioni duhet siguruar që zyrtarët t'i kenë me vete ato, dhe kur ka mungesë të tyre, të sigurohen nga logjistika. 1.7. Veç pajisjeve, IPK ka verifikuar respektimin edhe të standardit të uniformës së zyrtarëve policor. Neni 139 i Rregullores për Personel dhe Administratë përcakton si duhet bartur dhe çka përmban uniforma verore dhe dimërore (klasa A dhe B). Pas inspektimit të veshjes tek pesë (5) zyrtarë, ka rezultuar se përgjithësisht standardi i veshjes ka qenë duke u respektuar, me përjashtim të disa rasteve, ku distinktivi zyrtar nuk është përdorë me uniformë. Duhet theksuar se që disa vite ka mungesë të furnizimit të rregullt me rroba dimërore/verore për zyrtarët policor të Stacionit. 1.8. Dukja personale e zyrtarëve policor është element ndikues meqë përçon imazhin e tyre tek qytetarët. Rregullat mbi dukjen personale janë pasqyruar në nenin 148 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës. Standardi, i cili është përcaktuar me Rregullore del të jetë respektuar në mënyrë të kënaqshme nga zyrtarët policor të inspektuar në Stacion. Standardi në fjalë është respektuar edhe nga zyrtarët tjerë, të cilët janë hasur gjatë inspektimit. 1.9. IPK në të kaluarën ka rekomanduar që të ushtrohen në vazhdimësi inspektime (kontrolle) të armëve, municioneve, pajisjeve, dhe të hartohen raporte përkatëse, me qëllim që të avancohen standardet unike të punës në menaxhimin efikas dhe efektiv të burimeve. Në Stacion janë kërkuar raporte të inspektimeve, të realizuara nga ana e menaxherëve. Bazuar në raportet e siguruar, inspektime të tilla organizohen nga shefat e njësisë në baza mujore, mbikëqyrësit e ndërrimeve, por kohë pas kohe edhe nga drejtuesit. Lidhur me kontrollet mbahen shënime dhe përpilohen raporte⁵. 1.10. Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës përcakton që zyrtari policor duhet të përkujdeset që armën zyrtare ta mbajë dhe mirëmbajë në gjendje të rregullt. Zyrtari policor, pa marrë parasysh a është në kryerje të detyrës, apo jo, obligohet që armën zyrtare ta mbajë të pastër dhe në gjendje të rregullt për përdorim. IPK-ja ka
--	---

³ Neni 15 i Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës.

⁴ ID-11495, ID-2185, ID-11499, ID-11475 dhe ID-11492.

⁵ Raportet e inspektimeve të realizuara më 28.02.2023, 04.03.2023 dhe 11.05.2023.

	inspektuar pesë (5) zyrtarë policor, për të parë nëse kujdesen dhe mirëmbajnë armët e pajisjet, përfshirë dhe municionin. Pistoletat kanë rezultuar të pastra, spreji kimik të zyrtari i vetëm i pajisur është hasur me afat të skaduar, kurse jelekët anti - plumb kanë rezultuar me afat përdorimi. Fishekët janë ndërruar dhe janë zyrtar. Sa i përket sprejit duhet pasur parasysh se në rastet e mungesës së tyre, hendikepohet puna e zyrtarëve policor, kurse në anën tjetër, përdorimi eventual i atyre me afat të skaduar mund të ndikojë në shëndetin e personave, me të cilët mund të ketë ballafaqim. 1.11. Bazuar në nenin 100 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, përcaktohet që njësitë organizative në kuadër të Policisë, divizionet, drejtoritë në Departamentin për Shërbime Mbështetëse, Drejtoritë Rajonale duhet të përkujdesen që secili zyrtar policor i kësaj drejtorie, brenda periudhës kohore prej një (1) viti t'i mbajë së paku 40 orë trajnim (përfshirë edhe certifikimin). Lidhur me trajnimet e avancimin profesional të zyrtarëve policor të Stacionit, IPK ka gjetur se rreth 84% e tyre janë përfshirë në trajnim (122 nga 145 zyrtar policor kanë realizuar trajnimin gjatë vitit 2022, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 16% sipas menaxhmentit nuk është përfshirë për arsye të përfshirjes në plane operative, trajnime të avancuara, për shkak të pushimeve, sëmundjeve, suspendimeve, etj.). Janë realizuar gjithsej 4.880 orë trajnuese nga 5.800 orë të planifikuara për tërë personelin e uniformuar. Secili nga zyrtarët e përfshirë ka realizuar mesatarisht nga 40 orë brenda vitit. 1.12. Rregullorja në nenin 114 parasheh që gjithë zyrtarët policor, pa marrë parasysh nivelin dhe gradën policore, janë të obliguar që brenda periudhës kohore prej çdo 12 deri në 18 muaj ta vijnë trajnimin për ri-certifikim⁶. Ri-certifikimi ka për qëllim që të gjithë zyrtarët policorë, përmes këtij procesi t'i ri përsërisin dhe t'i rifreskojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, në mënyrë që të jenë sa më efikas dhe profesional në kryerjen e punëve policore. Nga të dhënat e siguruar nga Sektori i Resurseve, në 18 muajt e fundit, Ri-certifikimin nga radhët e personelit të uniformuar e kanë vijuar 126 nga 145 zyrtarë policor (87%). 1.13. IPK ka verifikuar nëse struktura hetimore e Stacionit është e pajisur me njohuri të nevojshme përmes programeve trajnuese/kurseve. Andaj, punonjësit e angazhuar në Sektorin e Hetimeve duhet të kenë kryer Kursin Bazik të Hetimit. Tre (3) nga 20 hetuesit e Sektorit të Hetimeve nuk e kanë kryer Kursin Themelor të Hetimit (ID-10368, ID-10903, ID-10233). PSO - Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje (kapitulli V, pika h) përcakton që çdo pjesëtar i Policisë që trajton raste të dhunës në familje duhet të jetë i trajnuar apo të ndjekë trajnimin adekuat profesional të organizuar nga Departamenti i Trajnimit/institucionet apo organizatat tjera. Dy (2) nga katër (4) hetuesit e dhunës në familje nuk e kanë të kryer kursin për hetimin e këtyre rasteve (ID-10213, ID-10936). Dy (2) zyrtarët e Dhomës së dëshmive nuk kanë kryer trajnimin përkatës (ID-0904 dhe ID-6336). PSO-Teknika Kriminalistike (Sektori i Vendit të Ngjarjes) parasheh që me qëllim të krijimit të një kriteri për trajnime për teknik kriminalistike nevojiten standardet e nevojshme, që do t'i plotësojnë teknikët kriminalist, të cilët punojnë në teknikë kriminalistike në tre (3) nivelet. Sipas kësaj, teknikët kriminalist që punojnë në stacione në kuadër të Ekipit të vendit të ngjarjes, me qëllim të plotësimit të kërkesave të njësisë, preferohet të jenë të certifikuar në trajnimet: Kursi Bazik për Teknik Kriminalist dhe Kursi Bazik i Hetimit. Duke u bazuar në kriterin e parë, del që të tre (3) zyrtarët e angazhuar në kuadër të Ekipit të Teknikës Kriminalistike kanë kryer kurs përkatës për këtë fushë.
--	---

⁶ Rregullorja për Personel dhe Administratë përcakton që varësisht nga niveli, apo grada e zyrtarit policor kryhet dhe ricertifikimi. Në kuadër të këtij procesi hyjnë ricertifikimet, që nuk kufizohen vetëm në: përdorimin-gjuajtjen me armë të zjarrit, ndalimin dhe kontrollimin e automjeteve dhe mjeteve tjera motorike, kontrollimin e turmave, taktikat mbrojtëse, ndihmën e parë, Kodin e mirësjelljes, informimin me aktet e reja normative, aftësimin në komunikim, planifikimin operativ e taktik, menaxhimin dhe lidershipin, menaxhimin e stresit/konfliktit/incidentit kritik, përpilimin e raportit, zgjidhjen e problemit, marrjen e vendimit, këshillimin e monitorimin, Policinë në Komunitet, raportin Polici-media, vlerësimin e performancës.

PSO-Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës (kapitulli B, pika 5) parasheh që zyrtarët policor në Qendrat e Ndalimit duhet të jenë të trajnuar dhe kualifikuar në raport me specifikat e punës që kërkon trajtimi i të ndaluarve. Dy (2) nga 11 zyrtarët e angazhuar në Qendrën e Mbajtjes (Mbikëqyrësi i Qendrës dhe 1 zyrtarë policore) nuk kanë të kryer kurset përkatëse për këtë fushë (ID-3486 dhe ID-1006).

1.14. Bazuar në rregullat në fuqi, stacionet trajtojnë shkeljet e lehta disiplinore që u drejtohen nga autoriteti kompetent policor (DSP-ja). Kjo fushë është rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat e Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës dhe PSO-në për Procedurën Disiplinore në Nivel Lokal (DPPK-01-PSO-01). Bazuar në nenin 13, nëse shkeljet bëjnë pjesë në kategorinë e shkeljeve të lehta disiplinore, hetimet fillojnë dhe përfundojnë në nivel lokal sipas kategorisë së shkeljeve të lehta. IPK ka siguruar tre (3) mostra të rasteve të trajtuara nga autoriteti hetues në nivel Stacioni⁷, ku janë vlerësuar nga aspekti i respektimit të rregullave-procedurave konform aktit për shkeljet e lehta disiplinore. Sa i përket epilogut të tyre, dy (2) lëndë janë mbyllur në nivel Stacioni në mungesë të provave për shkelje të lehta, ndërsa në një (1) rast i dyshuari është shpallë përgjegjës. Mostrat përmbajnë njoftimet për palët, vendimet, deklaratat e raportet përfundimtare. Afatet e trajtimit dhe kompetenca lëndore e hetimit lidhur me këto mostra janë respektuar konform Udhëzimit⁸ dhe PSO-së.

1.15. Për kryerjen e detyrave gjatë punës, menaxherët dhe drejtuesit janë të detyruar të vlerësojnë rezultatet në punë, të njohur si vlerësim performace. Bazuar në nenin 79 të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, punonjësit e Policisë lidhur me kryerjen e detyrave të punës i nënshtrohen vlerësimit periodik të performancës që ka për qëllim rritjen e cilësisë në punë dhe përmirësimin apo avancimin gradual të aftësisë profesionale të punonjësit. Sipas PSO-së, Policia, respektivisht mbikëqyrësi ku punonjësi punon, është i obliguar që së paku një herë në vit ta bëjë vlerësimin e performancës për punonjësin, që është nën mbikëqyrjen e tij. Lidhur me këtë, IPK-ja ka marrë pesë (5) mostra të vlerësimit të performancës (për 1 toger, 2 rreshter dhe 2 zyrtarë policor)⁹. Vlerësimi i performancës është bërë sipas formularit standard dhe është realizuar brenda afatit kohor. Nga vlerësimet e siguruar nuk është hasur ndonjë pakënaqësi apo ankesë kundrejt tyre.

2. Aktivitetet operative

2.1. Në Raportin e inspektimit “Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimit policor”, i dalur nga inspektimi i realizuar në të gjitha stacionet është pasqyruar se janë hasur dobësi në mbajtjen e logjeve operacionale¹⁰, andaj IPK-ja u ka rekomanduar komandantëve të stacioneve, shëfave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të ushtrojnë kontrole të shtuara përfshirë dhe auditime të planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logjet, drejt ngritjes së cilësisë së evidencës. IPK-ja ka siguruar logje të tre (3) muajve të fundit, për t’u siguruar se evidenca është cilësore, përditësuar me të dhëna mbi thirrjet dhe reagimin. Për dallim nga stacionet tjera, Logu operacional mbahet nga QOKR - Ferizaj dhe Stacioni nuk ka ndonjë përgjegjësi mbi cilësinë e tij dhe kontrollin. Thirrjet pranohen nga QOKR dhe nëse ato lidhen me Stacionin e Ferizajt, barten drejtpërdrejt tek mbikëqyrësit e ndërrimeve apo njësitë e caktuara.

2.2. PSO përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht lokacionit ku ndodhë rasti (me përjashtim në disa zona të thella malore e me kushte të papërshtatshme atmosferike). IPK-ja ka pasur fokus reagimin policor në thirrjet e qytetarëve dhe për të konstatuar

⁷ Dosjet nr. 00034-HBNL-2022-04/1-05, 00073-HBNL-2022-04/1-05 dhe 00006-HBNL-2022-04/1-05).

⁸ Neni 69, paragrafi 12 i Udhëzimit.

⁹ ID-1775, ID-1182, ID-7489, ID-10415 dhe ID-10926.

¹⁰ Logu është pasqyrë e krijuar elektronike, a me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cildo informues i mundshëm, për një ngjarje të caktuar të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër.

	efektivitetin e njësive policore janë kontrolluar 1.979 mostra ngjarjesh ku ka pasur reagim policor¹¹. Nga analiza e mostrave të thirrjeve të realizuara nga Stacioni gjatë muajve mars, prill dhe maj, rezultojnë këta indikatorë: (a) Në vitin 2023, koha e reagimit në thirrjet e qytetarëve është zgjatur (shtyrë) nga 8.49 në 10 minuta (koha mesatare e reagimit për të gjitha stacionet në vitin e kaluar ka qenë 13.76 minuta). (b) Stacioni ka zgjatur kohën e reagimit në zonë urbane për 1.6 minutë, nga 8.1, në 9.7 minuta (koha mesatare për stacionet në vitin e kaluar ka qenë 11.62 minuta). Stacioni ka zgjatur kohën e reagimit në zonë rurale për 1.5 minuta, nga 11.4 në 12.9 minuta (koha mesatare për stacionet ka qenë 20.79 minuta). (c) Raporti në përqindje ndërmjet reagimit me kohë dhe reagimit me vonesë është 89:11, krahasuar me vitin e kaluar që për Ferizaj ishte 94:6 (ky raport në nivel të stacioneve në matjet e vitit të kaluar ka qenë 80:20). 2.3. Bazuar në nenet 29, 30, 31 dhe 32 të Rregullores për Personel dhe Administratë, policët, rreshterët, togerët, si dhe kapitenët kanë përgjegjësi të raportimit, varësisht pozitave menaxhuese. IPK ka verifikuar nëse zyrtarët e Stacionit kryejnë raportimet e nevojshme sipas detyrave të parapara dhe nëse ato kryhen me kohë. Fillimisht janë siguruar raportet e patrullave mbi ngjarjet në ndërrimet e fundit, ku janë përfshirë fletë patrullat, Raporti 24 orë i situatës ditore i datës 30.05.2023 dhe i katër ditëve të fundit (gjithsej 5 ditë). IPK ka siguruar dhe raporte periodike të drejtuesve. Shihet se për aktivitetet ditore, zyrtarët policor përpilojnë raporte për detyrat e realizuara të ndërrimit (fletë patrulla), që inspektohen nga mbikëqyrësit dhe që bëhen pjesë e Raportit 24 orë në nivel të Stacionit. Sektorët e Operativës, Hetimeve dhe Resurseve raportojnë periodikisht dhe informatat i përmbledhin në raporte vjetore të Stacionit. 2.4. IPK ka përcjellë rugëtimin e rasteve deri te njësitë kompetente që vazhdojnë me trajtimin e tyre. Është detyrë e njësitit patrullues të komplotojë rastin e raportuar brenda zonës së përgjegjësisë dhe më pas t'ia dorëzoj Shefit të ndërrimit për kontroll dhe nënshkrim. Rasti duhet të dorëzohet nga njësiti i patrullës sa më parë që është e mundur dhe më së voni deri në përfundimin e orarit të punës. Rasti regjistrohet në Librin e rasteve në Zyrën e Bazës së Stacionit (në mënyrë elektronike dhe fizike). Përveç rasteve urgjente, rastet që iniciohen brenda 24 orëve (brenda tre ndërrimeve), çdo ditë (përjashtimisht vikendit dhe festave) në orën 08.30 të mëngjesit dorëzohen në Operativë, të cilat kontrollohen nga Shefi i Operativës se a janë kompletuar sipas procedurave të parapara dhe a janë në pajtim me KPRK, KPP e ligjet tjera në fuqi. Nëse rasti është i kompletuar, i dërgohet Komandantit apo zëvendësuesit të tij për nënshkrim. Pas nënshkrimit, rastet merren nga Zyrtari i SIPK, fotokopjohen dhe një kopje mbetet në arkiv (data bazë), kurse origjinali i dërgohet Njesisë së Hetimeve jo më vonë se në orën 09.00 për çdo ditë pune. Lidhur me procedimin e rasteve janë inspektuar nëntë (9) mostra¹² me raport fillestar të incidentit dhe rezultojnë se në të gjitha rastet ato janë regjistruar në Librin e rasteve, janë pranuar/kompletuar dhe nënshkruar nga Operativa, më pas janë dërguar te Komandanti, nga i cili në të gjitha rastet janë nënshkruar me kohë. Brenda afateve, rastet më pas janë pranuar nga Zyrtari i SIPK, janë regjistruar në data-bazë dhe më pas u janë shpërndarë njësive. 2.5. Patrullimet janë aktivitete që realizojnë stacionet në drejtim të krijimit të një mjedisi të sigurt për qytetarët. Sipas nenit 3 të Rregullores për Operativë, patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi e qetësia publike, sigurohet prona, lëvizja e lirë, kontrolli i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi e zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime e aktivitete tjera nga fusha
--	--

¹¹ Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR-ja, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla apo njësiti që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njesisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje.

¹² 2023-CF-1142, 2023-CF-1144, 2023-CF-968, 2023-CF-966, 2023-CF-967, 2023-CF-969, 2023-CF-1182, 2023-CF-965 dhe 2023-CF-964.

	e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit. IPK ka verifikuar prezencën e patrullave në orët e hershme të mëngjesit të datës 31.05.2023, para dorëzimit të ndërrimit 23.00-07.00. Është siguruar Orari ditor i angazhimit të patrullave dhe me ndihmën e Mbikëqyrësit të ndërrimit (ID-0828) janë verifikuar patrullat në terren. Sipas Orarit ishte paraparë që dy (2) nga katër (4) patrullat në përbërje të të cilave ishin pjesëtarë të ekipeve reaguese, të jenë mobile me automjete me nga tre (3) dhe dy (2) zyrtarë policor për të mbuluar pjesë të qytetit (P-1 dhe P-2), kurse patrulla e tretë dhe e katërt në këmbë për të mbuluar po ashtu pjesë të qytetit (P-3 dhe P-4). Në mëngjesin e datës 31.05.2023, patrullat janë hasur në përbërje të plotë dhe në thirrje varësisht kërkesave, por të angazhuar me tre (3) automjete mobile. Bie në sy që Orari patrullues nuk kishte paraparë patrullime në zona rurale por ka koncentruar gjithë kapacitetin operacional vetëm në lokacione të njëjta brenda në qytetit. 2.6. Patrullat kryejnë patrullime me automjete dhe në këmbë, por organizojnë edhe pika të kontrollit. Në trafik shkaktohen kundërvajtje, për të cilat stacionet shqiptojnë gjoba në drejtim të ngritjes së sigurisë në rrugë. Neni 10 i Rregullores për Operativë përcakton që ndalja e automjetit për shkak të kundërvajtjes në trafik, apo për qëllime tjera, në të shumtën e rasteve konsiderohet si detyrë e rregullt e zyrtarëve policor patrullues. Realizimi i patrullimeve dhe pikë kontrolleve varet nga një sërë faktorësh dhe nuk ka metodologji të caktuar se si duhet kombinuar këto aktivitete. Nga analiza e indikatorëve të performancës së Stacionit për vitin 2022 rezulton se: (a) Ka rënie të numrit të patrullimeve në këmbë për -4% dhe realizimi mesatar ditor prej gjashtë (6) patrullimesh, renditë Stacionin mbi mesataren e përgjithshme të stacioneve që është katër (4) patrullime ditore. (b) Ka rënie të numrit të patrullimeve me automjete për -4.5% edhe pse realizimi mesatar ditor prej tetë (8) patrullimesh e renditë Stacionin mbi mesataren e përgjithshme që është shtatë (7) patrullime. (c) Pikat e kontrollit kanë shënuar një rënie për -4.1% krahasuar me një vit më parë dhe realizimi mesatar ditor prej njëzetë (20) pika të kontrollit renditë Stacionin mbi mesataren e përgjithshme që është tetë (8) pika kontrolli. (d) Numri i gjobave ka shënuar ngritje për 80%, ku një polic i Stacionit ka shqiptuar mesatarisht 162 gjoba në vit, derisa mesatarja e përgjithshme për stacionet ka arritur në 98 gjoba për polic gjatë vitit. 2.7. IPK-ja është interesuar të njihet me funksionimin e SIPK-ut dhe procedurën e evidentimit të kundërvajtësve për shqiptim të masës mbrojtëse, pikëve negative dhe regjistrimin në evidencë fizike. Për dhjetë (10) mostra të kundërvajtjeve është gjetur se gjobat janë shqiptuar të plota konform Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor. Masat mbrojtëse, pikët negative dhe gjobat janë evidentuar në SIPK, lidhur me to mbahet edhe evidencë fizike, si dhe nuk ka shpëputje në raport me regjistrimin elektronik¹³. 2.8. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin e zbulimin e krimit, andaj Policia ndërmerr veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbuloj veprat penale dhe të kapë kryesit e tyre. Policia vepron po ashtu edhe në realizimin e urdhërësive të gjykatave dhe organet e drejtësisë e ngarkojnë atë që të sjellë para tyre të dyshuarit/të dënuarit, që mund të lidhen me vepra të ndryshme penale, apo për kundërvajtje. Nga analiza e të dhënave që pasqyrohen në Raportin statistikor të vitit 2022 vërehet një mospërputhje sa i përket bartjes së urdhërësive nga viti 2021 në vitin 2022, duke rrezikuar të mos paraqitet pasqyrë e qartë mbi performancën policore nga kjo fushë. Stacioni angazhohet në ekzekutimin e urdhërësive dhe nga analiza e indikatorëve të performancës për vitin 2022 rezulton se: (a) Stacioni ka pasur një kuotë të realizimit të urdhërësive në masën prej 59.2%.
--	---

¹³ Mostrat e inspektuara janë si vijon: 00026206668, 00026206711, 0002620707W, 0002694705I, 00026947583, 0002742607L, 0002828682O, 0002828764Q, 0002877992S dhe 00028510439.

	nën mesataren e përgjithshme të stacioneve (75.4%). (b) Kuota e urdhëresave të parashkruara ka qenë 0.9% e totalit të urdhëresave të disponueshme (2.5% më e ulët në raport me mesataren e stacioneve që është 3.4%), kurse kuota e urdhëresave të bartura në vitin 2023 është 39.9% e totalit të urdhëresave të disponueshme të Stacionit (18.8% më e lartë në raport me mesataren e përgjithshme për stacionet që është 21.1%). (c) Sa i përket ngarkesës dhe efikasitetit të realizimit të urdhëresave për polic, një i tillë nga Stacioni ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 22.1 sosh (mesatarja për stacione është 7.4 urdhëresa për polic), derisa ka realizuar 59.3% të tyre (13.1 nga 22.1), me të cilat është ngarkuar (përqindja mesatare për polic në stacione është 76%, apo duke realizuar 5.6 nga 7.4 urdhëresa të ngarkuara). 2.9. Në kuadër të detyrave, zyrtarët policor merren me realizimin e urdhëresave të gjykatave për vepra të ndryshme penale, përfshirë urdhëresat për ekzekutim dënimi (me burg), urdhër arreste (365 ditë), letër rreshtime, urdhëresa për kohë të caktuar (për paraqitje në seanca gjyqësore), urdhëresa për mbikëqyrjen e masave të arrestit shtëpiak dhe urdhëresa tjera. Nga dhjetë (10) dosjet e kontrolluara me urdhër arreste në kohë zgjatje 365 ditë dhe letër rreshtime, të cilat janë revokuar (tërhequr) nga organi kompetent, IPK-ja është interesuar për veprimet e ndërmarrja në realizimin e tyre. Jo në të gjitha mostrat janë ndërmarrë veprime në drejtim të realizimit të tyre. Për një numër të konsideruar të mostrave ka qenë e pamundur të identifikohet numri i saktë i vizitave, meqë nuk ka evidenca. Ka mostra ku vazhdimi i urdhëresave nuk është përcjellë me asnjë vizitë tek palët e kërkuara. IPK-ja është njohur që gjykatat janë njoftuar mbi mos prezencën e palëve (mos gjetjen), por përgjatë periudhës kur janë vazhduar urdhëresat, nuk janë kryer më vizita. Ka qenë e pamundur të nxirret numri i veprimeve për secilën nga to, meqë dosjeve iu mungon formulari përkatës, që mund të ofrojë shënime mbi vizitat e kryera tek palët e kërkuara, por edhe koha mesatare deri në veprimin e parë policor të realizimit të tyre. Më poshtë pasqyrohet aktiviteti policor për secilën urdhëresë mostër deri në revokimin (tërheqjen) e tyre: (a) Urdhër arresti P.nr.679/18 - asnjë (0) veprim policor, (b) Urdhër arresti nr. 2021:146258 - asnjë (0) veprim policor, (c) Urdhër arresti P.nr. 2351/17 - një (1) veprim policor, (d) Urdhër arresti P.nr.559/2011 - asnjë (0) veprim policor, (e) Urdhër arresti P.nr. 807/17 - asnjë (0) veprim policor, (f) Urdhëresa për Letër rreshtim P.nr.1695/17 - një (1) veprim policor, (g) Urdhër arresti P.nr.327/17 - tre (3) veprime policore, (h) Urdhër arresti P.nr.308/16 - dy (2) veprime policore, (i) Urdhëresa për Letër rreshtim P.nr.499/2016 - një (1) veprim policor, (j) Urdhëresa për Letër rreshtim P.nr.794/16 - asnjë (0) veprim policor. 2.10. Në të kaluarën është vërejtur se një numër i stacioneve kanë aplikuar heqjen e urdhër arresteve nga SIPK-u nga momenti kur atyre u skadon afati ligjor, derisa disa tjera, tërheqjen e kanë praktikuar pasi të kenë pranuar shkresa mbi tërheqjen, lëshuar nga organi kompetent. IPK është interesuar për përditësimin apo shlyerjen me kohë të urdhëresave nga SIPK-u dhe lidhur me këtë janë inspektuar dhjetë (10) mostra, tre (3) nga të cilat janë urdhëresa për shpallje të letër rreshtimeve, si dhe shtatë (7) urdhër arreste (365 ditë). Verifikimi në SIPK vë në pah se për të gjitha mostrat janë shlyer urdhëresat pas revokimit, apo tërheqjeve të tyre nga organi kompetent. Sa i përket shlyerjes me kohë, duhet potencuar se në të gjitha mostrat ka pasur azhuritet. 2.11. Ligji për Policinë rregullon fushën e përdorimit të forcës dhe armës së zjarrit nga zyrtarët policor, të cilët janë të autorizuar të përdorin forcë, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të Policisë. Udhëzimi Administrativ nr. 04/2019 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor parasheh raportimin e zyrtarit policor në rastet kur ai përdorë forcën fizike. Në vitin 2021 janë raportuar 68 raste të përdorimit të forcës me 132
--	--

	punonjës të përfshirë, kurse në vitin 2022 janë shtuar raportimet në 75 sosh. Vërehet ngritje e numrit të rasteve të raportuara me përdorim force për 10.3%. Një polic i Stacionit gjatë vitit 2022 ka arrestuar mesatarisht 6.5 dhe ka ndaluar 1.3 persona (mesatarja për stacionet është 3.9 të arrestuar dhe 1.5 të ndaluar për polic). Nga pesë (5) dosjet e inspektuar nga IPK del se në të gjitha rastet është plotësuar formulari unik i raportimit të përdorimit të forcës, ato kanë njoftimet drejtuar Drejtorisë Rajonale, e cila më pas ia ka drejtuar në kompetencë KSHPF-së për trajtim¹⁴. Rastet e inspektuara janë trajtuar nga KSHPF-ja dhe në të pestat është arsyetuar përdorimi i forcës nga zyrtarët policor, si dhe nuk ka pasur rekomandime. Rastet kanë raportet nga KSHPF-ja. Në katër (4) nga pesë (5) mostrat, deklaratat e zyrtarëve të përfshirë në raste janë pothuajse identike (04/1-05SRR/925/2022, 04/1-05-SRR-1578, 04/1-05SRR/964/2022 dhe 04/1-05SRR/867/2022). 2.12. Policia mbron jetën/pronën, ofron siguri për qytetarët, mbron liritë e të drejtat themelore të të gjithë personave, parandalon dhe zbulon veprat penale dhe kryesit e tyre, dhe kryen detyra tjera të parapara me ligj. Gjatë punës, Policia ndalon persona, që i mbanë në qendrat e ndalimit, por të cilëve duhet t'iu respektohen disa të drejta. Prokurori i Shtetit lëshon Aktvendim për të caktuar masën e ndalimit për 24/48 orë, në bazë të të cilit, zyrtarët policor i pranojnë personat e arrestuar në qendra ndalimi. I ndaluar duhet të njoftohet menjëherë nga momenti i vënies në dijeni mbi arsyet e arrestit të përcaktuar në nenin 165 të KPP-së. Sipas nenit 167, i arrestuari ka të drejtë që sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku ose dentisti, sipas zgjedhjes së tij, sa më shpejtë që të jetë e mundur pas arrestimit të tij dhe në çdo kohë gjatë ndalimit. Sipas nenit 168 të KPP, të ndaluarit për më shumë se 12 orë i sigurohen tre racione ushqimi në ditë. Koha e ndalimit nuk duhet të kalojë më shumë se 48 orë nga koha e arrestimit, përveç rasteve kur Gjyqtari i Procedurës Paraprake urdhëron ndryshe, respektivisht sipas nenit 65 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën 24 orë pas kalimit të kësaj periudhe. Nga pesë (5) mostra të kontrolluar del që lëndët kanë pasur aktvendim mbi ndalimin, të arrestuarit janë njoftuar për arsyet e arrestit, u janë lexuar të drejtat, u është siguruar ushqimi, sipas nevojës u është ofruar kontrolli mjekësor dhe se të njëjtit janë liruar me kohë¹⁵. 2.13. SIPK është bazë e të dhënave, ku bëhet verifikimi, regjistrimi, evidentimi i të gjitha rasteve, të cilat lajmërohen në Polici. Palët që kanë nevojë për verifikim të të kaluarës kriminale, mund të parashtrajnë kërkesë në stacione/nënstacione policore më të afërta të vendbanimit, apo vendqëndrimit të parashtruesit të kërkesës, tanimë edhe në platformën qeveritare e-Kosova. PSO - Verifikimi i të Kaluarës Kriminale parasheh që kërkesa, parashtruesi i të cilës nuk ka të kaluar kriminale duhet realizuar brenda 24 orëve, për ditë pune (verifikimi, konfirmimi, plotësimi dhe lëshimi i vërtetimit). Stacioni në vitin 2021 ka pranuar 6.049 kërkesa nga palët për t'u pajisë me vërtetime të kaluarës kriminale, kurse në vitin 2022 ky numër ka arritur në 6.956 kërkesa. Realizimi i kërkesave është në masën prej 95.4% për vitin 2021 dhe 96.2% për vitin 2022 (në vitin 2021 janë realizuar 5.771 kërkesa, derisa në vitin 2022 gjithsej 6.690 sosh). Janë inspektuar dhjetë (10) mostra për të verifikuar respektimin e afatit për lëshim me kohë të vërtetimeve¹⁶, pesë (5) nga të cilat kanë qenë kërkesa nga persona pa të kaluar kriminale, që iu janë lëshuar vërtetimet brenda dite apo 24 orëve, derisa pesë (5) kërkesa tjera janë ushtruar nga persona me të kaluar kriminale, që pas konfirmimit nga Gjykata/Prokuroria se janë shlyer nga evidenca e personave të dyshuar, apo kanë paguar gjobën përkatëse, iu janë lëshuar vërtetimet.
--	---

¹⁴Mostrat e përzgjedhura të rasteve të raportuara të përdorim të forcës: 01/1-05SRR/925/2022, 04/1-05-SRR-1578, 04/1-05SRR/964/2022, 04/1-05SRR/1576 dhe 04/1-05SRR/867/2022.

¹⁵ Rastet/dosjet me referencë: 2023-CF-1052 (2023/190), PP/1.nr.03/23 (2023/198), 2023-CF-1014 (180/2023), 2023-AU-130 (170/2023) dhe 2023-CF-920 (162/2023).

¹⁶ Mostrat: RN-2023-CF-2336, RN-2023-CF-2352, RN-2023-CF-2365, RN-2023-CF-2313, RN-2023-CF-2333, RN-2023-CF-372, RN-2023-CF-1556, RN-2023-CF-2053, RN-2023-CF-2311 dhe RN-2023-CF-1349,

2.14. Planet janë mjet menaxhimi, që lehtësojnë koordinimin e burimeve (njerëzore, financiare, teknike), që të jetë e mundur të arrihen qëllimet dhe objektivat. Në Polici janë disa nivele të përgatitjes së planeve (qendror, rajonal dhe lokal). IPK-ja është interesuar të njihet me planet që janë hartuar në nivel Stacioni. Nëse u referohemi të dhënave nga raportet krahasuese statistikore, përgjatë dy (2) viteve të fundit janë nxjerrë 81, përkatësisht 71 plane operative, nga të cilat IPK-ja ka kontrolluar pesë (5) sosh¹⁷. IPK ka pranuar dhe një Listë të planeve operative, që përmban një numër më të ulët të tyre (21 gjegjësisht 22 plane për dy vitet e fundit). Gjetjet vejnë në pah se për të gjitha mostrat ka pasur proces të analizës dhe vlerësimit, të dokumentuar me raporte pas operacionale. Në Raportin vjetor të punës (2022) pasqyrohet se shumica e veprave penale që janë më serioze kanë trend rënës, në përjashtim të rasteve të “dhunës në familje” dhe “vjedhjeve të rënda”, numri i të cilave ka shënuar ngritje për 95%, përkatësisht 19.1% krahasuar me vitin 2021. Në mesin e planeve operative të hartuara zënë vend edhe ato mbi parandalimin e vjedhjeve.

2.15. Fokus i inspektimit ka qenë dhe realizimi i planeve dhe njohja me ato që janë në zbatim. Në ditën ku është realizuar ky inspektim, sipas Orarit të patrullimit, Stacioni ka realizuar aktivitete patrulluese në zbatim të katër (4) planeve operative¹⁸. Lidhur me zbatimin e aktiviteteve patrulluese në funksion të këtyre planeve, janë kontrolluar tre (3) fletë patrulla të ekipeve patrulluese të ndërrimit II dhe nga aktiviteti i tyre është hasur se ka pasur aktivitete në përmbushje të planeve operative.

2.16. PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit përcakton se kur patrulla del në vend ngjarje dhe në bazë të informatave vlerëson se nuk ka elemente të veprës penale, apo të kundërvajtjes, atëherë patrulla përpilon Shënim zyrtar për veprimet e ndërmarra lidhur me informatën dhe e dërgon në Operativën e Stacionit përmes zinxhirit komandues. Shënimi zyrtar me shkresa përcjellëse protokollohet dhe arkivohet në Operativë ndërsa informatat në lidhje me Shënimin zyrtar përcillen tek njësia përkatëse (sektor policor, në Njësinë e Hetimeve, Inteligjencë e Stacionit, “nevoja për të ditur PUI”). Për të parë se sa respektohet PSO, IPK-ja ka kontrolluar dhjetë (10) lëndë, me fokus nëse kanë raporte, nëse janë evidentuar sipas rregullave (protokollimi dhe arkivimi), nëse janë trajtuar në mënyrën e duhur, nëse rastet që lidhen me pro-formën ndërlidhen me vepra penale, nëse është konsultuar Prokurori për rastet e tilla dhe nëse rastet janë përcjellë tek njësiti përkatëse¹⁹. Lëndët kanë Shënimin zyrtar, janë protokolluar, kur ka qenë e nevojshme është konsultuar edhe Prokurori i Shtetit dhe u janë shpërndarë njësive përkatëse. Asnjëri nga këto raste nuk ka rezultuar të jetë regjistruar në SIPK.

3. Parandalimi dhe luftimi i krimit

3.1. Neni 7 i Ligjit për Policinë përcakton se me qëllim të parandalimit e luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, Policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe komunitetet lokale. Strategjia për Policim në Bashkësi reflekton zotimin policor dhe përkushtimin në ngritjen e sigurisë në bashkësi me anë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me gjithë akterët, që mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi dhe që në mënyrë preventive veprojnë në identifikimin e zgjedhjen e problemeve, që shkaktojnë shqetësimin dhe frikën te qytetarët. Plani Veprues në kuadër të objektivave strategjike ka përcaktuar numër të konsideruar aktiviteteve,

¹⁷ Mostrat: “Parandalimi i vjedhjeve” (nr.04/1-05F-455/2021), “Parkingjet e parregullta” (nr.04/1-05F-903/2022), “Parandalimi i vjedhjeve në sektorin 1 dhe 2” (nr.04/1-05F-349/2022), “Testi i maturës” (nr.04/1-05F-682/2022) dhe “Siguria dhe stop drogave në shkollë” (nr. 04/1-05F-167/2022).

¹⁸ Planet operative në zbatim me Orar ditor të datës 31 maj 2023: “Siguria në trafikun rrugor”, “Kulti”, “Lëmshoh kërkuesit” dhe “Ngritja e vigjilencës dhe masave të sigurisë”.

¹⁹ Pro-format: 2023-SHZ-01, 2023-SHZ-02, 2023-SHZ-03, 2023-SHZ-004, 2023-SHZ-05, 2023-SHZ-06, 2022-SHZ-007, 2023-SHZ-38, 2023-SHZ-40 dhe 2023-SHZ-051.

ku veç tjerash janë përfshirë edhe: organizimi i takimeve për siguri nëpër shkollë, organizimi i takimeve me forume të sigurisë/mediat/OJQ-të, organizatat e ndryshme me qëllim të promovimit të strategjisë në bashkësi, identifikimi i pikave të zeza dhe problemeve në trafik, etj. Informatat e pranuar jo në të gjitha rastet mbështeten me raporte, procesverbale apo evidenca. Edhe Qeveria (MPB) ka nxjerrë Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Veprimit (2018-2023), ku një ndër akterët e përfshirjes është edhe Policia. Lidhur me angazhimet policore në fushën e policimit në bashkësi, Stacioni pasqyron se:

- Në vitin 2021 ka realizuar 12 takime me forumet e sigurisë, kurse në vitin 2022 janë realizuar 24 të tilla,
- Në vitin 2021 ka realizuar 80 vizita dhe 43 ligjërata në shkollë, kurse në vitin 2022 ka realizuar 78 vizita dhe 48 ligjërata në shkollë,
- Në vitin 2021 ka realizuar tre (3) takime me bizneset, kurse në vitin 2022 ka realizuar 26 të tilla,
- Në vitin 2021 ka realizuar një (1) takim me komunitetin kulturor dhe sportiv, kurse në vitin 2022 ka realizuar 18 të tilla,
- Nuk ka realizuar takime për kushtet e trafikut dhe pikat e zeza,
- Në vitin 2021 dhe 2022 nuk janë realizuar inspektime të rrugëve,
- Në vitin 2021 ka realizuar tre (3), kurse në vitin 2022 ka realizuar 19 takime me komunitetin,
- Ligjërata mbi aktivitetet e dyshimta lidhur me EDHRT nuk janë realizuar.

3.2. Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca është model pune dhe filozofi drejtuese, ku produktet e inteligjencës gjejnë përdorim të gjerë në procesin e vendimmarrjes, e që ka për qëllim parandalimin e reduktimin e krimit, si dhe zgjedhjen e problemit, duke u fokusuar në eliminimin e shkaktarëve, përmes menaxhimit strategjik dhe zbatimit efektiv të strategjive. Informata inteligjente është informatë e thjeshtë, që kalon në disa faza vlerësimi e verifikimi, ku në përfundim kemi produkt inteligjent, përmes të cilit parandalohet apo zgjidhet një problem. PUI nënkupton mbledhjen e informatave inteligjente për të vazhduar me parandalim dhe zgjidhje të problemeve, kështu që policimi në bashkësi do të ishte më efikas dhe efektiv. Stacioni në vitin 2021 ka dërguar përmes SIPK-ut, 598 raporte inteligjente, përmes Zyrtarit për Inteligjencë dhe Analizë, apo përmes zyrtarëve policor. Kurse, në vitin 2022 janë dërguar 1.046 informata inteligjente. Bazuar në të dhënat rajonale për 37 stacione, në vitin 2022 ka pasur ngritje të numrit të informatave inteligjente për 84%, krahasuar me një vit më parë. Kur krahasojmë performancën e Stacionit në raport me mesataren e përgjithshme për 37 stacionet del se në vitin 2021 një (1) zyrtar policor ka dërguar mesatarisht katër (4) informata inteligjente, derisa mesatarja e përgjithshme është dy (2) informata. Në vitin 2022, një (1) zyrtar policor ka dërguar mesatarisht shtatë (7) informata derisa mesatarja e përgjithshme është katër (4) sosh.

3.3. Sipas nenit 10 të Ligjit për Policinë, ndër detyrat e përgjithshme të Policisë janë të parandaloj dhe zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe të hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre. Bazuar në këto autorizime, stacionet policore kanë detyra të ndara në parandalimin, hetimin e zbulimin e krimit. Nga analiza e suksesit për 37 stacionet, pasqyrohet se ato gjatë vitit 2021 kanë pasur kuotë të zbulueshmërisë të veprave penale në lartësi prej 61.3%, derisa në vitin 2022 kjo kuotë është ngritur në 63.4%. Stacioni i Ferizajt, kuotat e tilla i ka pasur në lartësi prej 57.9% për vitin 2021, përkatësisht 61.5% për vitin 2022.

3.4. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave hetimore, IPK-ja ka kontrolluar kopjet fizike të pesë (5) mostrave të rasteve të dhunës në familje, që janë proceduar në Prokurori të Shtetit²⁰. Në kuadër të rasteve është vlerësuar rregullsia e

²⁰ 2023-CF-855, 2023-CF-481, 2023-CF-673, 2023-CF-366 dhe 2023-CF-685.

	lëndëve penale, nëse ato përmbajnë veprimet/dokumentet e formularët e nevojshëm lidhur me hetimin e dokumentimin e krimit. Është verifikuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore, përdorimi i formularëve standard brenda rasteve, si dhe regjistrimi i tyre sipas procedurës së regjistrimit të rasteve në regjistrat përkatës: (a) Konform KPP-së Stacioni ka ngritur kallëzime penale kundër të dyshuarve për veprën penale “Dhunë në familje” dhe të gjitha mostrat janë regjistruar në SIPK. Kallëzimet janë dorëzuar në Prokurori bashkë me procesverbalet, raportet dhe format bazike të të dhënave të rasteve. Kallëzimet penale nuk janë nënshkruar sipas PSO-së²¹. Në pesë (5) mostra, kallëzimet janë nënshkruar nga Hetuesi dhe Shefi i Sektorit të Hetimit, duke mos kaluar përmes Mbikëqyrësit të vijës së parë (rreshteri). Lënda 2023-CF-685 është gjetur e nënshkruar vetëm nga Hetuesi. Lëndët janë proceduar në Prokurori të Shtetit përmes SMIL-it dhe fizikisht²². Procedimi i lëndëve përmes SMIL dokumentohet, por ka mangësi në futjen e dokumenteve (urdhrrat mbrojtës, të cilët kanë qenë aktiv dhe janë të lidhur me mostrat, nuk janë hasur në Sistem). Koha mesatare e procedimit të kallëzimeve në Prokurori sipas mostrave është 3.2 ditë nga hapja e rasteve. (b) Në të gjitha rastet e marra si mostra dëshmohej që në proces për trajtimin e viktimave nuk janë përfshirë zyrtarë të QPS, po ashtu nuk janë gjetur të dhëna mbi pjesëmarrjen e Mbrojtësit të viktimave²³. (c) Viktimave u është ofruar trajtim mjekësor, por vetëm në një (1) rast viktimat ka shfrytëzuar të drejtën ligjore për ekzaminim mjekësor dhe mbi ekzaminimin është nxjerrë raport mjekësor. Në rastet e tjera nuk është pranuar ekzaminimi, sepse ankuesit e kanë vlerësuar të panevojshëm. (d) Sipas procedurave në fuqi, në fazën e veprimeve fillestare, Policia vlerëson rrezikun për viktimën e dhunës në familje në praninë edhe të Mbrojtësit të viktimave. Lidhur me këtë, si pjesë e vlerësimit të rrezikut, Policia duhet të përgatisë formën bazike të të dhënave për rastin²⁴. Në të gjitha rastet e marra si mostër është vlerësuar shkalla e rrezikut bazuar në indikatorë përkatës. (e) Pakoja informuese për viktimat e krimit, që përmban kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin është obligative që nga viti 2020, që të jetë pjesë e rastit dhe dosjes. Në secilin rast, viktimat janë pajisur me këtë Pako. (f) Gjatë inspektimit janë marrë mostra të rasteve ku ndaj viktimave janë aplikuar urdhra mbrojtës. Është vlerësuar nëse ka qenë e nevojshme marrja e veprimeve me qëllim të zbatimit të tyre. Bazuar në dokumentet e pranuar, nuk ka pasur raste të raportimit për mosrespektim të urdhrat mbrojtës nga të dyshuarit deri në momentin e inspektimit. Policia ka treguar gatishmëri që të bashkëpunojë duke iu ofruar ndihmën e nevojshme viktimave me qëllim të ofrimit të sigurisë. (g) Në kuadër të kriterëve për kontrollimin e dosjeve është vlerësuar prezenca e Raportit policor brenda dosjes hetimore, që i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale²⁵. Në tre (3)
--	--

²¹ Kallëzimet para procedimit nënshkruhen nga hetuesi, mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (rreshteri) dhe përmes tij, nga Shefi i Hetimeve.

²² Kur përfundon hetimi, hetuesi duhet të dërgoj lëndën për nënshkrim tek Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve dhe përmes tij tek Shefi i Hetimeve. Më tutje, PSO përcakton se pas procedurave të lartcekura, hetuesi lëndën e regjistron në modulin për Sistemin SMIL dhe e përcjellë në Prokurorinë e Shtetit.

²³ Sipas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Mbrojtësi i viktimave është personi i autorizuar zyrtar, i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

²⁴ Kapitulli 5.2 i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, faqe 33.

²⁵ Sipas nenit 71, paragrafi 6 të KPP-së Posa policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë prokurorin e shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve.

	prej dosjeve është gjetur që kallëzimi penal bashkë me raporte policore janë proceduar tek Prokurori brenda 72 orëve, ndërsa në dy (2) raste tjera nuk është gjetur njoftim me shkrim brenda afateve të parapara ligjore bazuar në KPP në fuqi, po ashtu edhe në atë të shfuqizuar. (h) Policia ka të hartuar formularët e nevojshëm të punës, që iu shërbejnë zyrtarëve policor gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Formularët e përdorur brenda dosjeve hetimore janë unik dhe ka një standard të caktuar të hartimit të tyre, mirëpo është gjetur që me rastin e ndryshimeve ligjore, të njëjtit nuk janë harmonizuar me aktet ligjore në fuqi (KPP i ri). (i) Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut²⁶. IPK ka vlerësuar respektimin e të drejtave në procedurë paraprake gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe dëshmitarëve. Deklaratat janë nënshkruar nga palët, përmbajnë të drejtat e personave të intervistuar, por nuk janë harmonizuar me ndryshimet ligjore. 3.5. Sa i përket interesimit të IPK-së lidhur me kushtet fizike e të sigurisë në Dhomën e Dëshmive, është gjetur që Dhoma është e vendosur në bodrum brenda objektit të Stacionit. Dera e saj është e punuar nga materiali i fortë, kapëset nyjore të saj janë të vendosura nga pjesa e brendshme e derës dhe se të njëjtat janë të siguruar siç parashihet në PSO. Dhoma ka dritare, të konstruktuar për të pamundësuar qasjen përmes tyre. Dhoma është e pajisur me aparat për fikje të zjarrit (afati i saj është i skaduar), po ashtu ka të instaluar sistemin e alarmit kundër hyrjes së paautorizuar i cili testohet rregullisht. Dhoma ka të instaluar detektorët e tymit (nuk janë kryer teste për të ditur nëse është funksional). Sistemi i ventilimit dhe kondicionimit është funksional, kurse nuk ka sistem të ngrohjes së hapësirave të Dhomës. Dhoma u siguron qasje të kufizuara personave që e vizitojnë atë dhe çdo hyrje e personelit tjetër regjistrohet në Regjistër të qasjes. Dhoma është e monitoruar me kamera të sigurisë, në to nuk ka qasje Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmive. 3.6. Sipas rregullit, çdo lëvizje e sendit a dëshmisë duhet të regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën duhet bashkëngjitur kopja e raportit të ekzaminimit, që duhet të ruhet në dosjet e Dhomës së dëshmive²⁷. Në të gjitha rastet e inspektuara janë evidentuar lëvizjet e dëshmive në mënyrën e duhur. Dëshmitë e deponuara në pesë (5) rastet e inspektuara kanë të bashkëngjitur zinxhirët e ruajtjes së bashku me dëshmitë. Të dhënat për dëshmitë e deponuara janë evidentuar në Libër fizik dhe Bazë elektronike të të dhënave. Numri i dëshmive fizike (artikujve) me informatat në Regjistrin e dëshmive²⁸ dhe Zinxhirin e ruajtjes për dëshmitë e inspektuara është në përputhje. Zyra e pranimit të dëshmive gjendet një kat më lartë prej Dhomës së dëshmive, e njëjta është ndarë nga zona e deponimit të dëshmive. Në Dhomën e dëshmive nuk deponohen dëshmi të rrezikshme si eksploziv, materie radioaktive, mjete zjarrovënës, materie helmuese a ndonjë materie kimike të natyrës së dëmshme. Sipas PSO-së, origjinali i formës së zinxhirit të ruajtjes duhet të mbetet në Dhomë
--	--

²⁶ Bazuar në nenin 122 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara me Ligj dhe i njëjti duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave të lexuara nga hetuesi.

²⁷ PSO në kapitullin E, paragrafi 17 dhe 18 rregullon që çdo lëvizje e sendit/dëshmisë, të dorëzuar në gjykatë apo njësi tjetër, që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, regjistrohet në Regjistër dhe në bazën e të dhënave. Nëse sendi dhe dëshmia është dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik, kjo lëvizje regjistrohet në Regjistër të dëshmive dhe data bazë. Kur dëshmitë me urdhëresë kërkohen nga Gjykata-Prokuroria, dorëzohen për ekzaminim/analiza apo ri-ekzaminim në laborator, kjo regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën bashkëngjitet kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e dhomës së dëshmive.

²⁸ PSO në kapitullin G, paragrafi 3 përkufizon se "regjistri i dëshmive është një regjistër (formular apo libër) për regjistrimin e të gjitha dëshmive të konfiskuara apo provave të gjetura, të vjedhura etj. Të gjitha dëshmitë të cilat gjenden të deponuara në dhomë duhet të regjistrohen në regjistër të dëshmive.

	të dëshmimeve së bashku me sendin/dëshminë, ndërsa kopja, në dosjen e dëshmisë²⁹. Zinxhirët e ruajtjes në origjinal mbahen në Zyrën e Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmimeve dhe kjo bëhet për të rritur sigurinë në ruajtjen e tyre, sepse në disa raste Dhoma e dëshmimeve është prekur nga uji për shkak të reshjeve të shtuara atmosferike. Kopja e Zinxhirit të ruajtjes i është bashkëngjitur secilës dëshmi. 3.7. IPK ka vlerësuar mënyrën e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve të sekuestruara. Gjetjet rezultojnë pozitive dhe në harmoni me kriteret e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve. Vendosja dhe paketimi i dëshmimeve në të gjitha rastet është bërë duke iu përshtatur specifikave të tyre. Dëshmitë e inspektuara janë të siguruara me shiritin bllobues. Dhoma ka frigorifer për ruajtjen e dëshmimeve biologjike, por i njëjti është jashtë funksioni. Armët e zjarrit deponohen në dhomë të ndarë, apo në arkë metalike brenda zonës deponuese. Bankënotat e gjërat e çmuar deponohen në një sef të ndarë brenda zonës së deponimit. Hapësira brenda Dhomës plotëson mjaftueshëm nevojat për të deponuar dëshmitë. Zyrtari përgjegjës mbanë evidencë për sistemin e numrit, emërtimin e raftit, udhëzimin ku gjenden dëshmitë apo sendet e deponuara dhe ka qenë i gatshëm që të identifikoj dëshmitë në kohë të shkurtër. I njëjti mban evidencë mbi dëshmitë në Librin e dëshmimeve dhe në Bazën elektronike të të dhënave. 3.8. Me qëllim të ushtrimit të kontrollit adekuat, duke bërë rishikim formal periodik dhe verifikues për të vërtetuar korrektësinë e rrjedhën e punës, verifikim të pranisë së sendeve e dëshmimeve të mbajtura në Dhomë të dëshmimeve në krahasim me regjistrat, dhe të vlerësohet rrjedha e punës duke shikuar përmbushjen e procedurave, aspektin e sigurisë e kushtet e punës së zyrtarëve policor, organi kompetent duhet të realizojë revizion³⁰, inventarizim³¹ dhe inspektim³² në Dhomën e dëshmimeve. Për vitin 2021 dhe 2022 janë kryer inventarizimet, gjë që e dëshmojnë edhe raportet. Veç këtyre formave të kontrollit, në vitin 2021 është realizuar një (1) inspektim në Dhomën e dëshmimeve, derisa në vitin 2022 janë realizuar tre (3) inspektime, të dëshmuara me raporte. 4. Kushtet teknike të punës dhe të sigurisë 4.1. Stacioni ka 17 automjete, nga të cilat, dhjetë (10) në gjendje funksionale (59%) dhe shtatë (7) të tjera jashtë funksionit (41%). Nga një inspektim i realizuar në vitin 2022, IPK ka kryer analiza, që kanë pasqyruar se një (1) automjet zyrtar mesatarisht ka qenë në dispozicion të nëntë (9) punonjësve policor. Kjo mesatare dallon paksa tek Stacioni i Ferizajt, meqë sipas matjeve, një (1) automjet është në dispozicion të mesatarisht dhjetë (10) punonjësve të tij. Sa i përket vjetërsisë, del se automjetet e këtij Stacioni kanë mesatarisht 7.5 vjet jetëgjatësi, moshë kjo më e re krahasuar me moshën e përgjithshme të Flotës së automjeteve të Policisë (11 vjet). Kurse, sa i përket amortizimit teknik, automjetet e Stacionit kanë të kaluara mesatarisht nga 182.290 kilometra, që paraqet shkallë më të ulët amortizimi në raport me mesataren
--	--

²⁹ PSO - Dhomat e dëshmimeve, pika G, paragrafi 2 përkufizon se "zinxhiri i ruajtjes së sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur është dokument apo formular i domosdoshëm që evidenton - prezanton konfiskimin, pranim-dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmimeve, si dhe prezencën apo qasjen e zyrtarëve policor".

³⁰ Revizioni është rishikim formal periodik dhe verifikues për të vërtetuar korrektësinë dhe rrjedhën e punës. Revizion i duhur është një inspektim i paanshëm i parimeve, procedurave dhe veprimeve për ta përcaktuar nëse apo jo, janë përcjellë standardet. Revizioni bëhet në bazë të një plani, i jashtëzakonshëm, kur ka informata se ka thyerje të integritetit të sistemit dhe kur kemi ndërrim të personelit.

³¹ Inventarizimi është regjistrim dhe verifikim i pranisë së sendeve e dëshmimeve të mbajtura në Dhomë të dëshmimeve në krahasim me regjistrat. Zyrtari policor i sendeve dhe dëshmimeve duhet të kryej një inventarizim komplet së paku një herë në vit, çdo herë që ka ndërrim të personelit, apo me kërkesë të organit kompetent.

³² Inspektimi është shikim apo këqyrje e punës, që duhet të jetë i shpejtë, joformal, zakonisht i paparalajmëruar, rishikim i procedurës, regjistrat, nëse Dhoma e dëshmisë është e pastër dhe në rregull, shëndeti i zyrtarit policor dhe siguria e tij, dëshmia e dorëzuar në mënyrë të rregullt, si dhe procedura standarde e operimit, a janë përfillur. Inspektimi periodik është menduar për të plotësuar e mbështetur revizionin e rregullt dhe inventarizimin e rregullt.

	e përgjithshme për tërë Flotën e Policisë, automjetet e së cilës sipas matjeve nga viti i kaluar kanë pasur mesatarisht nga 217.640 kilometra të kaluara. 4.2. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës në nenin 6 dhe 7 ka përcaktuar detyrat e përgjegjësitë në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Edhe Doracaku i Parimeve e Procedurave, në Parimin P-10.01 lidhur me shfrytëzimin e automjeteve, ka përcaktuar përgjegjësitë e detyrat e mbikëqyrësve/përdoruesve të automjeteve në mirëmbajtjen ditore sipas formularit të listës së verifikimit të automjetit. Nga inspektimi i automjeteve rezultojnë se para përdorimit, zyrtarët policor kryejnë kontroll vizual të tyre dhe verifikojnë prezencën e pajisjeve brenda automjeteve sipas formularit standard të kontrollit të pajisjeve³³. Po ashtu edhe Zyrtari i mbikëqyrjes së automjeteve realizon inspektime të rregullta dhe një nga inspektimet e fundit ishte ai i datës 13.04.2023. 4.3. Sipas nenit 39 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete përcakton se në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara dhe të posedojnë certifikatë të regjistrimit të mjetit valide, ose leje valide për ngasje provuese, të jetë i shënuar me targë regjistrimi ose targa provuese të vendosura për identifikim të mjetit. Kontrollimi i certifikatave të regjistrimit dhe policave të sigurimit vë në pah se të gjitha automjetet janë të siguruar/regjistruara me kohë dhe nuk ka ndodhur që të ketë vonesa në regjistrimin me kohë të tyre. 4.4. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës obligon çdo drejtues të automjetit zyrtar që në Fletë udhëtim të shënojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, numrin e kilometrave të kaluara në momentin e kthimit dhe nënshkrimin e përdoruesit. Sa përket kësaj fushe, Udhëzimi respektohet plotësisht pasi fletë udhëtimet plotësohen rregullisht dhe përmbajnë të dhënat e nevojshme. 4.5. PSO për Flotën Operative përcakton që “mbikëqyrësi i secilës njësi që posedon automjete, duhet të sigurohet që ato të pastrohen në mënyrë periodike, jashtë dhe brenda, që t’i mirëmbahet pamja”. Gjatë kontrollit është parë se kjo pikë zbatohet plotësisht, meqë automjetet janë hasur të pastra, si brenda ashtu dhe jashtë. 4.6. Bazuar në nenin 207 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t’i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë, si: poçet rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. Pajisjet duhet të jenë të kompletuara dhe me afat përdorimi. Sipas nenit 203 të Ligjit, shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet t’i mbaj me vete mes tjerash certifikatën e regjistrimit, policën e sigurimit dhe Raportin Evropian të Aksidentit. Sipas nenit 26 të Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 01/2018 për Kontrollimin teknik të automjeteve, kontrollimi i pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjetit përfshinë: çelësin e rrotave, ngritësen mekanike - hidraulike, gomën rezervë, aparatën e fikjes së zjarrit, trekëndëshin, ndihmën e parë, dritat rezervë, pajisjet e dimrit-zinxhirët. IPK ka pasur fokusin te Lista e pajisjeve të paraparë me legjislacionin e lartshënuar dhe inspektimi i gjashtë (6) automjeteve³⁴ nxjerrë në pah se: a) Pesë (5) nga gjashtë (6) automjetet e inspektuara kanë aparate për fikje të zjarrit me afat të skaduar (23.06.2020), b) Të gjashtë (6) automjetet e inspektuara nuk kanë Raport Evropian të Aksidentit. 4.7. Inspektorët kanë verifikuar masat e sigurisë brenda dhe jashtë Stacionit, si faktor me rëndësi për të siguruar burimet, pronën dhe palët. Duke pasur parasysh që objekti i Stacionit është objekti i njëjtë ku është vendosur edhe DRP-Ferizaj, kjo e fundit
--	---

³³ IPK ka siguruar formularët standard të kontrollimit të automjeteve të ditës kur edhe është realizuar inspektimi.

³⁴ Automjetet: Police-003-07, Police-092-07, Police-097-07, Police-151-07, Police-111-07 dhe Police-108-07.

	ka hartuar më 7 nëntor 2008, Planin Operativ - Evakuimi, plan ky që i ka përcaktuar përgjegjësitë e personelit për sigurinë. Sa i përket masave të sigurisë vihet re se: - Objekti mbulohet me sistem monitorimi përmes kamerave 24/7, rrezja e të cilit mbulon perimetrimin e jashtëm dhe të brendshëm të tij³⁵. Sistemi mbikëqyret nga një dhomë e ndarë përmes monitorit, kurse administrohet nga DTIK-u, - Porta para hyrjes së përparme të objektit të Stacionit është e mbuluar 24/7 me një polic statik, i cili komunikon me palët dhe i orienton ata. Në hyrje të objektit një polic pranon palët dhe evidenton hyrje - daljet në Regjistrin përkatës, - Stacioni është i pajisur me magnetometër dhe skaner për kontrollin e personave, por të njëjtit janë hasur jo funksional, - Aparatet për fikjen e zjarrit janë vendosur në pika kyçe të objektit, por janë me afat të skaduar³⁶, - Stacioni ka lokalizuar vendin për zbrazje të sigurt të armës afër hyrjes kryesore, - Higjiena brenda dhe jashtë Stacionit është e nivelit të dëshiruar. 4.8. Qendra e Ndalimit është e vendosur në bodrumin e ndërtesës së Stacionit dhe ka pesë (5) qeli me nëntë (9) shtretër. Lidhur me kushtet fizike dhe të sigurisë është vërejtur se brenda Qendrës së Ndalimit: - Ka sistem funksional të monitorimit që përdoret për të monitoruar të ndaluarit³⁷ (rrezja e monitorimit të 6 kamerave mbulon qelitë dhe korridorin). Monitorimi realizohet përmes monitorit, që përcillet nga Zyrtari në Qendër të Ndalimit, - Ka ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial³⁸, - Lidhur me ajrosjen brenda saj kundërmon një aromë e rëndë që vie nga lagështia që ka dëmtuar edhe muret (nuk është sanuar tërësisht kjo problematikë), - Ka detektorë të tymit, - Ka lavamanë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, - Nuk janë hasur mjete që mund të paraqesin burim për kërcënim të jetëve të të ndaluarve, - Higjiena është në nivel të dëshiruar, mbulesat dhe shtretërit janë hasur të pastra dhe nuk ka pasur shenja të konsumimit të duhanit, - Janë hasur regjistrat, si: Libri i vizitorëve, Forma e regjistrimit për furnizim me ushqim, Regjistri i pranimit - dorëzimit të detyrës dhe Regjistri për personat e ndaluar në Qendër të Ndalimit³⁹, i) Ka sirtar për vendosjen e pronës së të ndaluarve dhe brenda paketimeve janë hasur mes tjerash edhe lidhëset e mbathjeve⁴⁰. Sirtari mbyllet me çelës dhe bie
--	---

³⁵ Neni 76 i Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton që personat në sektorin publik mund t'i instalojnë sistemin e vëzhgimit me kamera për vëzhgim të objektit nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe pasurisë.

³⁶ Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, në nenin 13 parasheh që punëdhënësi të sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit, të njëjtat të jenë me mbushje adekuat sipas llojit të shkaktarit të zjarrit. Këto duhet të vendosen në vende të përshtatshme, të jenë në gjendje të rregullt dhe të rimbushen në afate të caktuara.

³⁷ PSO-Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës në kapitullin E (Detyrat dhe përgjegjësitë), paragrafi 9 përcakton që çdo zyrtar policor në Qendrën e Ndalimit obligohet që përmes kamerave dhe në mënyrë vizuale të monitorojë dhe të kujdeset për sjelljet e të ndaluarit e posaçërisht kur vëren shqetësime që i paraqiten personit të ndaluar.

³⁸ PSO- Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës në kapitullin D (Procedura), paragrafi 1.8 përcakton që të gjitha dhomat në Qendrat e ndalimit duhet të jenë të pastra, të një madhësie të arsyeshme për numrin e personave të akomoduar dhe të kenë ndriçim të duhur (d.m.th. të mjaftueshme sa për të lexuar, pa përjashtuar periudhat e gjumit) dhe ajrosje/ventilim: mundësisht, dhomat duhet të kenë dritë natyrale.

³⁹ PSO- Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës në kapitullin E (Detyrat dhe përgjegjësitë), paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 përcaktojnë obligimin që Qendrat e ndalimit të kenë Librin për evidentimin e personave të ndaluar (A3), Librin për evidentimin e vizitorëve apo ekipeve monitoruese (A3), Librin për pranimin - dorëzimin e detyrës nga zyrtarët policor (A3) dhe Regjistrin për furnizim me ushqim për të ndaluarit në Qendër të ndalimit.

⁴⁰ PSO- Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës në kapitullin D (Procedura), paragrafi 1.5 përcakton që prona personale e personave të ndaluar duhet të menaxhohet me një kujdes të veçantë dhe gjësendet e tyre të vendosen në paketime, të regjistrohen në formën përkatëse dhe ato duhet të vendosen në një pliko/qese letre të mbyllur që përmban të dhënat personale të personit të ndaluar dhe duhet të ruhen në sirtar të mbyllur me çelës.

	në sy përdorimi i paketimeve adekuate, j) Nuk është vërejtur nga evidencat që kjo Qendër të jetë vizituar nga persona të pa autorizuar. Komunikimi mes të ndaluarve dhe avokatëve zhvillohet në një dhomë të veçantë brenda Qendrës së Ndalimit, k) Ushqimi për të ndaluarit sigurohet nga një furrë buke dhe ndahet me kohë sipas vakteve sipas intervaleve të përcaktuara me rregulla, por janë hasur edhe ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit, nga të ndaluarit dhe Mbikëqyrësi i Qendrës, l) Nuk janë hasur shenja të konsumimit të duhanit, m) Personeli përgjegjës përkujdeset që të ndaluarit të mos kenë qasje në lidhëset e mbathjeve të tyre. 4.9. Mjetet e punës janë faktorë me rëndësi për punë profesionale e të suksesshme. Stacioni në Ferizaj ka pasqyruar disa vështirësi lidhur me funksionimin e pajisjeve të kontraktuar (fotokopje), problem ky që sipas menaxhmentit po ndikon negativisht në aktivitetet administrative. Stacioni ka pasqyruar se ka këtë gjendje me pajisje të punës: - Fotokopje - 5 copë në funksion, shërbimet e të cilave janë të kontraktuara, - Printer - 8 copë (7 janë funksional), shërbimet e njërit prej tyre janë kontraktuar - Kompjuter - 46 copë (40 janë funksional), - Llap top - 2 copë (1 funksional), - Pajisje për matje të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve - 2 copë (1 funksional), - Alkooteste - 2 copë (funksional). 4.10. Rregullorja (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore në nenin 18 përcakton që inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Kjo Rregullore përcakton tutje se organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jofinanciare. Procesi i inventarizimit është udhëhequr nga niveli qendror. 4.11. Rregullorja në fjalë përcakton që të gjitha organizatat buxhetore obligohen që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. IPK-ja ka verifikuar prezencën fizike në raport me Listën e pajisjeve - inventarit në pesë (5) zyra të Stacionit (të Komandantit, Asistentit Administrativ, Shefit të Operativës, Shefit të Resurseve dhe Arkivës). Zyrat kanë ekspozuar Listat e pasurive në vende të dukshme dhe të dhënat brenda tyre mbështeten nga prezenca e pajisjeve dhe inventarit brenda zyrave.
Vlerësimi i përgjithshëm (përfundime) 	1. Organizimi dhe burimet njerëzore: 1.1. Stacioni ka të tejkaluar numrin e lejuar të burimeve njerëzore, problem ky që pritet të sanohet me zbatimin e Strukturës së re organizative. 1.2. Stacioni nuk mbanë të plotë Regjistrin e vijueshmërisë në punë të personelit, meqë ai përmban të dhëna vetëm për personelin me orar të rregullt të punës (08.00-16.00). Regjistri për këtë pjesë të stafit është përputhur me gjendjen apo prezencën fizike të tij në ditën e inspektimit. 1.3. Ka vërejtje sa i përket mbajtjes complete të pajisjeve policore, por ka edhe mungesë të sprejit dhe radiolidhjeve. 1.4. Në Stacion respektohet standardi i uniformës zyrtare dhe i dukjes personale. Janë evidentuar disa shqetësime në radhët e personelit, sa i përket furnizimit të rregullt me veshmbathje zyrtare. 1.5. Kontrollat e pajisjeve janë të rregullta dhe për to hartohen raporte. 1.6. Armëve dhe municionit u kushtohet kujdes i duhur sa i përket mirëmbajtjes, spreji është hasur pa afat, kurse jelekët anti - plumb janë me afat.

	1.7. Shkalla e realizimit të trajnimeve të brendshme brenda regjionit dhe atij të ri-certifikimit është e kënaqshme. 1.8. Ka nevojë për përfshirje më të gjerë të hetuesve në programet trajnuese nga fusha e hetimit të krimit dhe trajtimit të dhunës në familje. 1.9. Shkeljet e lehta disiplinore në nivel të Stacionit janë trajtuar me kompetencë, sipas procedurës dhe brenda afateve kohore të trajtimit. 1.10. Vlerësimi i performancës në punë është kryer në të gjitha mostrat, brenda afatit dhe sipas formularit standard. 2. Operativa: 2.1. Logu operacional azhurnohet kënaqshëm si rezultat i përkushtimit të stafit të QORK, mbikëqyrësve të ndërrimit në stacion, por dhe njësisve reaguese. 2.2. Stacioni ka kohë të shkëlqyer mesatare të reagimit në thirrjet e qytetarëve, megjithëse sivjet ka pasur zgjatje të kësaj kohe krahasuar me vitin paraprak. 2.3. Varësisht prej niveleve drejtuese dhe operative, Stacioni kryen raportimet e nevojshme mbi aktivitetet policore. 2.4. Procedimi i rasteve me raporte fillestare të incidenteve ka ndjekë procedurën dhe afatet kohore të trajtimit (adresimit). 2.5. Patrullat janë hasur duke patrulluar në lokacionet sipas Orarit ditor dhe me përbërje të plotë konform Planit. 2.6. Vitin e fundit edhe pse ka pasur trend rënës të aktivitetit patrullues krahasuar me vitin paraprak, indikatorët tregojnë se aktiviteti i tillë është mbi nivelin mesatar të stacioneve policore. Pasqyrohet një aktivitet i shtuar në gjobitjen e shkelësve të rregullave të trafikut rrugor. 2.7. Nga mostrat që kanë rezultuar me konfiskim të patentë shoferëve, me masë mbrojtëse dhe me pikë negative, rezulton se ato janë regjistruar në evidencë fizike/elektronike dhe gjobat janë shqiptuar të plota konform ligjit në fuqi. 2.8. Kuota e realizimit të urdhëresave është nën nivelin mesatar të stacioneve, të përcjellë me një përqindje të lartë të urdhëresave të bartura. Evidenca mbi numrin e urdhëresave të bartura dhe atyre të mbetura ka mospërputhje. 2.9. Lidhur me vizitat tek palët e kërkuara me urdhëresa, ka mungesë shënimesh mbi numrin e veprimeve, andaj edhe nuk pasqyrohet sa duhet puna e bërë në ekzekutimin e urdhëresave. 2.10. Të gjitha mostrat e urdhëresave që u kanë skaduar afatet, apo për të cilat ka pasur njoftime mbi tërheqjen (revokimin), janë shlyer me kohë nga SIPK-u. 2.11. Shtimi i raportimeve për përdorim të forcës dhe numri i lartë i të arrestuarve në raport me numrin e policëve jep indikacion se përdorimi i forcës kërkon analizë e vlerësim të duhur, me qëllim të identifikimit të faktorëve ndikues. 2.12. Dosjet e ndalimit janë në harmoni me ligjin dhe ndaj personave të ndaluar janë respektuar të drejtat e përcaktuara me ligjin në fuqi. 2.13. Stacioni është azhur në verifikimin e kërkesave të palëve që kanë aplikuar për të kaluarën kriminale (vërtetimet). 2.14. Janë përpiluar kënaqshëm plane që adresojnë shqetësimet e qytetarëve, apo që i kontribuojnë ngritjes së situatës së sigurisë. Për realizimin e planeve ka pasur procese të analizës - vlerësimit pas operativ të dëshmuara me raporte. 2.15. Në ndërrimin e inspektuar, ekipet patrulluese kanë pasur disa plane operative në zbatim, gjë që e dëshmojnë edhe orari i patrullimit dhe fletë patrullat. 2.16. Rastet me Shënim zyrtar janë trajtuar sipas standardit, por asnjëri nga to nuk është regjistruar në SIPK, si rezultat i ngarkesës dhe ndërrimeve të stafit. 3. Parandalimi dhe hetimi i krimit: 3.1. Me gjithë punën e kryer në zbatim të Strategjisë për Policimin në Bashkësi, nuk mbahen sa duhet procesverbale dhe raporte të aktiviteteve të realizuara.
--	--

- 3.2. Në vitin 2022 pasqyrohet një performancë pozitive në ngritje të numrit të informatave inteligjente krahasuar me vitin paraprak dhe mesatarja e numrit të tyre për polic është mbi mesataren e përgjithshme të stacioneve.
- 3.3. Nga indikatorët e luftimit të krimit shihet se në dy vitet e fundit (2021/2022), zbulueshmëria e veprave penale nga Stacioni ka qenë pothuajse në shkallë të njëjtë me nivelin e mesatares së përgjithshme të stacioneve.
- 3.4. Raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale në disa raste është gjetur që praktikohet si raportim verbal nga hetuesit për Prokurorin. Kallëzimet penale që lidhen me mostra janë proceduar me kohë në Prokurori, me disa vërejtje sa i përket respektimit të zinxhirit komandues lidhur me procedimin e tyre (nënshkrimet nuk janë dhënë nga tërë zinxhiri komandues i paraparë me PSO). Vlerësimi i rrezikut për viktimat bazuar në indikatorët përkatës është kryer në të gjitha rastet. Viktimat e dhunës në familje sipas nevojës i janë nënshtruar ekzaminimit mjekësor, duke përmblusur të drejtën e tyre për ekzaminim. Rastet e përzgjedhur si mostra janë regjistruar në SIPK dhe SMIL, por është hasur që gjatë evidentimit të tyre në këtë të fundit, nuk janë përfshirë edhe urdhrat mbrojtës. Formularët në dosje nuk janë azhurnuar (harmonizuar) me ndryshimet ligjore.
- 3.5. Kushtet teknike dhe të sigurisë brenda Dhomës së dëshmive duhet avancuar edhe më tutje.
- 3.6. Vërehen rezultate pozitive në mënyrën e ruajtjes së dëshmive dhe evidencës së tyre, ku çdo dëshmi e kontrolluar është trajtuar sipas rregullave të PSO-së.
- 3.7. Format e kontrollit/mbikëqyrjes nga menaxhmenti në Dhomën e dëshmive janë evidente.

4. Kushtet teknike të punës dhe të sigurisë:

- 4.1. Stacioni ka një numër automjeteve që plotëson nevojat me gjithë faktin se 59% në ditën e inspektimit ka qenë në funksion, me parametra teknik më të mirë se tërë Flota e automjeteve policore (jetëgjatësia dhe amortizimi).
- 4.2. Automjetet policore mirëmbahen dhe kontrollohen para përdorimit të tyre, kurse inspektimet janë të rregullta dhe të planifikuara.
- 4.3. Të gjitha automjetet policore janë regjistruar me kohë.
- 4.4. Fletë udhëtimet azhurnohen me kohë me të dhënat e nevojshme.
- 4.5. Automjetet policore janë hasur të pastra, si brenda ashtu edhe jashtë, duke ofruar imazh pozitiv tek qytetarët mbi këto asete policore.
- 4.6. Automjetet janë pajisur mirë me pajisje rezervë, përveç se pjesa dërmuese e tyre kanë aparate për fikje të zjarrit me afat të skaduar të përdorimit dhe nuk kanë Raportin Evropian të Aksidentit.
- 4.7. Masat e sigurisë në Stacion janë të kënaqshme, në përjashtim të skanerit të kontrollit të personave që është jashtë funksionit dhe aparateve për fikjen e zjarrit që u ka skaduar afati përdorues.
- 4.8. Qendra e Ndalimit plotëson shumicën e kushteve fizike dhe të sigurisë, por ka vërejtje sa i përket prezencës së lagështisë, kundërmimit të aromës së rëndë dhe cilësisë së ushqimit për të ndaluarit.
- 4.9. Stacioni ka vështirësi sa i përket funksionimit të pajisjeve të zyrës (pajisjeve fotokopjuese dhe printuese), si rezultat i mirëmbajtjes jo të duhur të tyre nga kompania e kontraktuar dhe kjo po ka efekt negativ në aktivitetet ditore.
- 4.10. Inventarizimi i pasurive është kryer, listat e pasurive janë hasur në zyra dhe të dhënat e tyre përputhen me prezencën fizike të pasurive.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁴¹ (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorin Rajonal dhe Drejtorin e Personelit të ndërmarrin veprime në adresimin e çështjeve që lidhen me sistemin dhe shpërndarjen e drejtë të personelit konform Rregullores së organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Policinë e Kosovës (24.03.2023).	-I-	Jemi në proces të pritjes së sistemit të Strukturës së re organizative, ku edhe sistematizimi i personelit do të jetë i shpërndarë sipas LPA-së e me funksionalizimin e LPA-së do të realizohet edhe ky rekomandim.	K-2 2024
2.	Për arsye të sigurisë, IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Logjistikës që të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me sprej dhe radiolidhje.	-I-	Tash më veç iu kanë dërguar kërkesat DRP-së për furnizimin e zyrtarëve me sprej dhe radiolidhje.	K-4 2023
3.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Divizionin e Trajnimeve të ndërmarr hapa në drejtim të përfshirjes më të gjerë të hetuesve të Stacionit në programet trajnuese apo kurse nga fusha e hetimit të krimit dhe trajtimit të dhunës në familje.	-II-	Janë dërguar listat me emrat e zyrtarëve në DRP, të cilët është e nevojshme që të certifikohen me trajnimet përkatëse në fushën e hetimeve në përgjithësi, duke përfshirë edhe trajnimin për rastet e dhunës familje dhe jemi në pritje të nivelit të DPP-së se kur do të organizohen këto trajnime.	K-3 2024
4.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të rrisin angazhimet në drejtim të ngritjes së shkallës së realizimit të urdhëresave të gjykatave.	-I-	Kemi angazhuar personel shtesë në këtë detyrë e po ashtu kemi edhe P.O. aktiv si dhe DRP po ashtu është duke e planifikuar edhe angazhimin e njërive tjera shtesë të DRP-së sa i përket kësaj detyre.	Në vazhdimësi
5.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të ushtrojnë kontrolle mbi njësinë përkatëse për ndërlidhje me Gjykata që për të gjitha veprimet policore në drejtim të ekzekutimit të urdhëresave, të evidentohen dhe dokumentohen me shkrim brenda përmbajtjes së dosjes.	-I-	Është bërë kërkesa në DRP që të sigurohet libri zyrtar për zbatimin e urdhëresave, i cili libër do të sigurojë edhe informacione për statusin e lëndës. Operativa ka përgatitur një formular ku do të evidentohen të gjitha veprimet shtesë që ndërmerren për zbatimin e urdhëresave.	Në vazhdimësi
6.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operativës që të analizojnë dhe vlerësojnë faktorët që ndikojnë në numrin e lartë të të arrestuarve në raport me numrin e policëve, por edhe të shtimit të raportimeve për përdorimin e forcës.	-II-	Gjatë periudhës K-3 do të bëhet një analizë në lidhje me rekomandimin ku do të identifikohen edhe faktorët që kanë rritur numrin e rasteve që lidhen me përdorimin e forcës.	K-3 2023
7.	IPK-ja i rekomandon Shefit të Operativës që të ushtrojë kontroll mbi Zyrën e SIPK-ut në mënyrë që të gjitha rastet e mbetura me Shënim zyrtar (pro forma) të regjistrohen në SIPK.	-I-	Me datën 15.08.2023, Shefi i Operativës ka angazhuar stafin e SIPK-ut që në baza ditore të trajtoj me prioritet regjistrimin e SHZ në SIPK.	K-3 2023

⁴¹ Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 17.08.2023, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

8.	IPK-ja i rekomandon Sektorit të Hetimeve që posa Policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, Policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë Prokurorin e shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve (neni 71, paragrafi 6 i KPP-së).	-I-	Me datë 15.08.2023 është mbajtur takim me Shefin e Hetimeve dhe i është kërkuar që për të gjitha veprat penale që ndiqen zyrtarisht me raport ta njoftoj Prokurorin sipas nenit 71 paragrafit 6 i KPP-së.	Në vazhdimësi
9.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Hetimeve që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët para se ato të procedohen në Prokurorinë e Shtetit, të aprovohen së pari nga hetuesi i lëndës, mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas nga Shefi i Sektorit të Hetimeve bazuar në PSO-Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.	-I-	Me datën 15.08.2023 është mbajtur takim me Shefin e Hetimeve dhe i është kërkuar që të respektohet procedura për procedimin e rasteve sipas hierarkisë. Me LAP është e nevojshme që të plotësohen pozitat e lira me gradën e rreshterit brenda njësisë së hetimeve pasi që ka mungesë të rreshterëve.	Në vazhdimësi
10.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës të sigurojnë shërbimet e kontraktuara për mbushjen e pajisjeve kundër zjarrit, për të siguruar se pajisjet e tilla janë në gjendje funksionale në rast fatkeqësish.	-I-	Kjo çështje tash veç është ngritur përmes shkresave disa herë që nga skadimi i afatit të aparateve për fikjen e zjarrit dhe jemi në pritje që niveli i DRP-së apo DPP-së të realizojnë rekomandimin e IPK-ës.	Në vazhdimësi
11.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me shërbimet mbështetëse të Policisë të adresojnë çështjen e lagështisë brenda Qendrës së Ndalimit, si dhe cilësinë e ushqimit për të ndaluarit.	-I-	Është ngritur kjo çështje tash përmes shkresave në DRP disa herë dhe jemi në pritje.	Në vazhdimësi
12.	IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të adresojë problemet e Stacionit Policor të Ferizajt lidhur me vështirësitë teknike në funksionimin e duhur të pajisjeve të kontraktuara (fotokopjeve).	-I-	Shefi i Administratës së Stacionit disa herë e ka adresuar deri më tani mosfunksionimin e fotokopjeve në nivel të DRP-së përmes kërkesave, e cila gjendje ende nuk është përmirësuar, por jemi në pritje që niveli i DRP-së apo DPP-së të realizojnë këtë rekomandim.	Në vazhdimësi

Shtojca

Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi burimet njerëzore të Stacionit Policor të Ferizajt (kategoria A)			
Kategoria	Burimet njerëzore të planifikuara	Gjendja (më 31 dhjetor 2022)	Gjendja (më 31 maj 2023)
Personel i uniformuar	115	142 (+27)	168 (+53)
Shërbyes civil	7	7 (0)	6 (-1)
Gjithsej	122	149 (+27)	174 (+52)

Tabela nr. 2 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me reagimin në thirrjet e qytetarëve			
Treguesi (indikatori)	Matjet për stacionet (2022)	Matjet për Ferizaj (2022)	Matjet për Ferizaj (2023)
Numri i mostrave	15.105	2.242	1.979
Koha e përgjithshme e reagimit policor	13.76	7.49	10.01
Koha e reagimit në zonë urbane	11.62	8.06	9.65
Koha e reagimit në zonë rurale	20.79	11.37	12.98
Raporti në % ndërmjet reagimit me kohë/të shtyrë	80/20	94/6	89/11

Tabela nr. 3 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me ekzekutimin e urdhërësive		
Treguesi (indikatori)	Viti 2021	Viti 2022
Kuota e realizimit të urdhërësive në raport me stacionet tjera	54% (72.7%)	59.2% (75.4%)
Kuota e parashkrimit të urdhërësive në raport me stacione tjera	2.2% (10%)	0.9% (3.4%)
Kuota e urdhërësive të mbetura në raport me stacionet tjera	43.8% (17.8%)	39.9% (21.1%)
Ngarkesa e policëve me urdhërësive në raport me stacionet tjera	20.6 (8.1)	22.1 (7.4)
Efektiviteti në realizimin e urdhërësive në raport me stacionet	11.1 (5.9)	13.1 (5.6)
Kuota e realizimit të urdhërësive për polic	53.9% (72.8%)	59.3% (75.7%)

Tabela nr. 4 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me patrullimet dhe gjobat e trafikut		
Treguesi (indikatori)	2021	2022
Numri i patrullimeve në këmbë	2.300	2.209
Mesatarja e patrullimeve në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	6.3 (4.3)	6.1 (4.3)
Numri i patrullimeve me automjet	3.346	3.196
Mesatarja e patrullimeve në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	9.2 (6.1)	8.8 (6.9)
Numri i pikave të kontrollit	7.723	7.409
Mesatarja e pikave në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	21.2 (7.7)	20.3 (7.5)
Numri i gjobave të shqiptuara	12.786	23.061
Mesatarja e gjobave në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	35 (15.5)	63.2 (21)
Mesatarja e gjobave për polic në raport me mesataren e përgjithshme (për vit)	86.4 (64.2)	162.4 (97.9)

Tabela nr. 5 - Pasqyrë tabelore mbi angazhimet në mbledhjen e informatave inteligjente		
Indikatorët e performancës	2021	2022
Numri i informatave inteligjente të dërguara nga Stacioni	598	1.046
Numri i përgjithshëm i informatave inteligjente të 37 stacioneve	6.679	12.306
Numri i informatave për zyrtar policor në raport me mesataren e stacioneve	4 (2)	7 (4)

Tabela nr. 6 - Pasqyrë mbi indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit		
Indikatorët e performancës	2021	2022
Numri i veprave penale	1.723	1.726
% e zbulueshmërisë së stacionit në raport me mesataren për stacione	57.9 (61.3)	61.5 (63.4)